



USHTRIA



Viti i 82-të i botimit Nr. 33 (827988)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 21 gusht 2026



» faqe 3



NGA TOKA, MBËSHTESIM ÇDO MISION NË AJËR BAZA AJRORE E KUÇOVËS, NYJA LOGJISTIKE QË MBAN NË GATISHMËRI MJETET AJRORE TË ANGAZHUARA NË OPERACIONET KUNDËR ZJARREVE

Në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në vend, ndërhyrja nga ajri është vetëm një pjesë e misionit. Pas çdo fluturimi qëndron një strukturë e tërë mbështetëse, e cila siguron furnizimin, përgatitjen dhe rikthimin e mjeteve ajrore në zonat e operacionit. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim po luan Baza Ajrore e Kuçovës...

faqe 4



NGA SFIDA E PARË TE BARAZIA E MERITËS, RRUGËTIMI I GRUAS SHQIPTARE NË FORCAT E ARMATOSURA

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të jesh grua është të mbartësh njëkohësisht forcën dhe ndjeshmërinë, përgjegjësinë dhe përkushtimin, familjen dhe profesionin. Të jesh grua në uniformë do të thotë të zgjedhësh një rrugë ku fjala detyrë merr një kuptim të veçantë dhe ku kontributi matet...

faqe 8



KRISTAQ XHARO – NJË JETË NË UNIFORMË, NJË MENDJE NË SHËRBIM TË DIJES DHE ATDHEUT

Në faqet e Shtypit Ushtarak kanë zënë dhe do të zënë vend njerëz që me jetën, shërbimin dhe veprën e tyre kanë lënë gjurmë në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare. Për ne, ruajtja e kësaj kujtese nuk është thjesht një detyrë botuese; është pjesë e misionit për të përcjellë te brezat përvojën, vlerat dhe kontributin e njerëzve që i kanë shërbyer vendit me përkushtim. Në këtë kuadër...

faqe 6

Forcat e Armatosura të Shqipërisë dhe Garda Kombëtare e New Jersey-t vijnë partneritetin strategjik 25-vjeçar

Një ekip i **Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH)** mori pjesë në konferencën e planifikimit të **Programit të Partneritetit Shtetëror**, zhvilluar në **Gardën Kombëtare të New Jersey-t, SHBA**.

Konferenca u fokusua në përcaktimin e prioriteteve të bashkëpunimit ndërmjet dy palëve, objektivat e stërvitjeve të përbashkëta, si dhe angazhimet dhe aktivitetet që do të zhvillohen gjatë dy viteve të ardhshme.

Takimi përbën një tjetër hap në konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ushtarak ndërmjet Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, duke krijuar mundësi të reja për shkëmbimin e përvojave, zhvillimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërveprueshmërisë së strukturave ushtarake.

Partneriteti ndërmjet **Forcave të Armatosura shqiptare dhe Gardës Kombëtare të New Jersey-t** ka një histori 25-vjeçare dhe është shndërruar në një nga shembujt më të qëndrueshëm të bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes. Gjatë këtyre viteve, ky partneritet ka përfshirë një gamë të gjerë aktivitetesh, duke nisur nga stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta, deri te shkëmbimi i përvojave profesionale dhe zhvillimi institucional.

Bashkëpunimi ka kontribuar në forcimin e kapaciteteve të FARSH-it dhe në rritjen e **gatishmërisë operacionale**, duke i dhënë një dimension të rëndësishëm edhe procesit të përafrimit dhe ndërveprimit me strukturat ushtarake të vendeve aleate.

Konferenca e zhvilluar në New Jersey shërbeu gjithashtu si një mundësi për të vlerësuar rezultatet e bashkëpunimit të deritanishëm dhe për të përcaktuar fushat ku partneriteti mund të thellohet më tej. Përcaktimi i objektivave konkrete për dy vitet e ardhshme synon që aktivitetet e përbashkëta të jenë sa më të orientuara drejt nevojave dhe prioriteteve të të dyja forcave.

Në një mjedis të sigurisë që kërkon gjithnjë e më

Shqipëri – SHBA: Planifikohet bashkëpunimi i përbashkët për dy vitet e ardhshme



shumë **bashkëpunim, ndërveprueshmëri dhe gatishmëri të përbashkët**, partneritete të tilla marrin një rëndësi të veçantë.

Për Forcat e Armatosura të Shqipërisë, marrëdhënia me Gardën Kombëtare të New Jersey-t përfaqëson një përvojë të konsoliduar bashkëpunimi, e cila ndërtohet mbi besimin,

shkëmbimin e ekspertizës dhe angazhimin e përbashkët për forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes.

25 vite partneritet Shqipëri–New Jersey janë dëshmi e një bashkëpunimi të qëndrueshëm, i cili vijon të zhvillohet me objektiva të reja dhe me një perspektivë të qartë për të ardhmen.

KFOR X në Pejë, trajnim për forcimin e gatishmërisë operacionale

Kontingjenti shqiptar zhvillon trajnimin “Fire Phobia” dhe CRC për përballimin e situatave emergjente

Kontingjenti **KFOR X**, pjesë e **Regjimentit të Këmbësorisë së Veriut (RKV)**, zhvilloi me sukses trajnimin **“Fire Phobia” dhe CRC (Crowd Riot Control)**, në kuadër të përgatitjes dhe ruajtjes së kapaciteteve të tij operacionale.

Trajnimi kishte për qëllim forcimin e gatishmërisë së efektivëve për reagimin ndaj situatave emergjente, si dhe përmirësimin e aftësive për menaxhimin dhe kontrollin e incidenteve me turma.

Gjatë zhvillimit të trajnimit, efektivët u përballën me **skenarë të simuluar**, të cilët kërkonin reagim të shpejtë, disiplinë të lartë, koordinim ndërmjet strukturave dhe zbatim korrekt të procedurave të përcaktuara.

Përmes këtyre skenarëve, personeli testoi aftësitë individuale dhe kolektive, duke synuar rritjen e efektivitetit në situata ku kërkohet vendimmarrje e shpejtë dhe veprim i koordinuar.

Trajnimet e këtij karakteri kanë një rëndësi të veçantë për strukturat e angazhuara në misionin **KFOR**, ku ruajtja e gatishmërisë dhe aftësia për t’iu përgjigjur situatave të ndryshme përbëjnë elemente thelbësorë të përmbushjes së detyrës.

Bashkëpunimi, koordinimi dhe ndërveprueshmëria me strukturat e tjera dhe me aleatët mbeten në qendër të përgatitjes së efektivëve të Forcës Tokësore. Përvoja e përbashkët në stërvitje dhe trajnime kontribuon në rritjen e kapaciteteve dhe në forcimin e aftësisë për të vepruar në mënyrë të unifikuar në kuadër të m

Zhvillimi i trajnimeve të tilla dëshmon angazhimin e personelit të KFOR X për të ruajtur standardet e kërkuara profesionale dhe për të qenë i gatshëm për përballimin e çdo situatë që mund të kërkojë ndërhyrje të organizuar dhe të disiplinuar.

Në Pejë, përgatitja vijon: gatishmëri, disiplinë dhe bashkëpunim për një mision të sigurt dhe efektiv.



BMEC vijon angazhimin në përballimin e emergjencave civile

Efektivët e Komandës Mbështetëse, në terren për izolimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit në Dajt dhe Mirditë

BMEC, si një nga strukturat kryesore të **Komandës Mbështetëse** në përballimin e emergjencave civile, vijon angazhimin e saj të pandërprerë në operacionet për përballimin e situatave të krijuara nga zjarret në disa zona të vendit.

Në malin e Dajtit, efektivët e Forcave të Armatosura vijnë ndërhyrjen në terren, duke u përballur me vështirësitë e relievit malor dhe kushtet e krijuara nga zjarri. Me përkushtim dhe këmbëngulje, ata po punojnë **për izolimin dhe shuarjen e vatrave**, duke synuar parandalimin e përhapjes së mëtejshme të flakëve. Puna në terrene të vështira kërkon angazhim të vazhdueshëm të personelit, koordinim dhe gatishmëri të lartë operacionale. Efektivët e BMEC vijnë të qëndrojnë në terren, duke ndërhyrë në zonat ku kërkohet mbështetja e Forcave të Armatosura.

Ndërkohë, **Detashmenti i Mbështetjes Rajonale, Mengël**, ka realizuar një tjetër operacion në bashkinë Mirditë, duke iu bashkuar strukturave të angazhuara në përballimin e situatës së krijuar nga zjarret.

Ndërhyrja e strukturave të Forcave të Armatosura synon të kontribuojë në mbrojtjen e zonave të rrezikuara, kufizimin e përhapjes së zjarreve dhe garantimin e sigurisë së komuniteteve.

Operacionet vijnë në koordinim me strukturat e tjera të emergjencave civile, zjarrfikësit dhe autoritetet vendore.

Nga Dajti në Mirditë, efektivët e Forcave të Armatosura mbeten në terren, aty ku kërkohet ndërhyrja dhe mbështetja e tyre. Angazhimi i tyre në këto situata është një dëshmi e gatishmërisë dhe e përgjegjësisë për t’i shërbyer qytetarëve dhe për të mbrojtur pasuritë natyrore të vendit.



NË FRONTIN E ZJARRIT – FORCAT E ARMATOSURA NË MBROJTJE TË JETËS DHE NATYRËS

Nga toka dhe ajri, efektivët e FA vijnë në betejën për izolimin dhe shuarjen e vatrave të zjarrit në disa zona të vendit

Në verën e nxehtë, kur zjarri shtrihet me shpejtësi në sipërfaqet pyjore dhe terrenet e vështira, një tjetër front i rëndësishëm hapet për Forcat e Armatosura: **mbrojtja e jetës së njerëzve, e banesave dhe e pasurive natyrore të vendit.**

Pamja që shoqëron këtë kronikë e përcjell qartë realitetin e këtyre ditëve. Në një terren të përfshirë nga tymi, një efektiv i Forcave të Armatosura ndjek nga toka ndërhyrjen ajrore. Mbi kurorat e pemëve, helikopteri manovron për të hedhur ujë mbi vatrën e zjarrit. Është një moment që flet më shumë se çdo deklaratë: **në tokë dhe në ajër, njerëzit e FA janë aty ku kërkohet ndërhyrja.**

Një operacion në disa fronte

Forcat e Armatosura vijnë në të jenë të angazhuara intensivisht në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në disa zona të vendit.

Në **Malin e Dajtit, Tiranë**, vijon puna e forcave operacionale, të mbështetura nga rreth **50 efektivë të FA dhe mjete ajrore të Forcës Ajrore**. Sipas situatës së raportuar, nuk paraqitet rrezik për zonat e banuara, ndërsa ndërhyrja vijon për izolimin e vatrave. Në zonën e Priskës situata është nën kontroll, ndërsa Vakumona është izoluar.



Në **Lufaj të Mirditës**, operacioni vijon me angazhimin e **9 efektivëve dhe dy mjeteve zjarrfikëse të Forcave të Armatosura**. Vatra nuk paraqet rrezik për banesat.

Në **Fushë-Lajë dhe Tërbun të Pukës**, FA-të janë të angazhuar në terren për izolimin dhe shuarjen e vatrave. Në Tërbun operacioni mbështetet edhe nga ajri me **dy helikopterë**, ndërsa në terren po punohet për hapjen e korridoreve ndarëse, një ndër masat më të rëndësishme për kufizimin e përhapjes së zjarrit.

Situata në Tërbun raportohet nën kontroll dhe pa rrezik për zonat e banuara.

Në **Gurë-Lurë, Dibër**, zjarri është izoluar falë korridoreve të hapura. Puna vijon për shuarjen e plotë të vatrës me **30 efektivë të FA-së dhe dy avionë “Air Tractor”**, ndërsa edhe këtu nuk paraqitet rrezik për banesat.

Nga toka drejt qiellit

Në operacionet kundër zjarreve, terreni shpesh përcakton mënyrën e ndërhyrjes.

Kur zjarri përparon në zona të thepisura, pyje të dendura apo hapësira ku mjetet tokësore e kanë të vështirë të afrohen, **ndërhyrja nga ajri bëhet një komponent i domosdoshëm i operacionit.**

Helikopterët dhe avionët zjarrfikës ndërhyjnë mbi vatrat aktive, ndërsa efektivët në tokë punojnë për hapjen e korridoreve, izolimin e zjarrit dhe shuarjen e vatrave të mbetura.

Është një punë që kërkon koordinim të vazhdueshëm, disiplinë dhe qëndrueshmëri fizike. Çdo ndërhyrje nga ajri duhet të plotësohet nga puna në tokë, sepse shuarja e një zjarri nuk përfundon me hedhjen e ujit mbi flakë. **Pas saj vjen detyra e kontrollit, izolimit dhe parandalimit të riaktivizimit të vatrës.**

Njeriu përballë flakëve

Në foto, përballë tymit dhe zjarrit, shfaqet një efektiv që ndjek ndërhyrjen ajrore. Është një imazh simbolik i një pune që zhvillohet shpesh larg vëmendjes së publikut.



Pas çdo operacioni janë njerëzit. Janë efektivët që ecin në terren të vështirë, që punojnë pranë vatrave, që hapin korridore ndarëse dhe që qëndrojnë në gatishmëri për orë të tëra. Janë ekuipazhet ajrore që operojnë në kushte të vështira, duke u përballur me tymin, temperaturat e larta dhe terrenin malor. Janë zjarrfikësit, strukturat vendore, shërbimi pyjor dhe vullnetarët që bashkohen në të njëjtin qëllim.

Të gjithë në një front.

Dhe ky front nuk ka të bëjë vetëm me shuarjen e një zjarri. Ka të bëjë me mbrojtjen e komuniteteve dhe të pasurisë natyrore.



FA, aty ku kërkohet ndërhyrja

Angazhimi i Forcave të Armatosura në përballimin e emergjencave civile është një prej detyrave të rëndësishme të tyre. Në situata të tilla, kapacitetet njerëzore, mjetet tokësore dhe ato ajrore vihen në funksion të një misioni të vetëm: **të kufizohet dëmi dhe të mbrohet jeta dhe prona.**

Nga Dajti në Tërbun, nga Mirdita në Dibër, efektivët e FA-

së po veprojnë në kushte dhe terrene të ndryshme, duke u përshtatur me dinamikën e zjarreve. Ndonjëherë puna është të hapësh një korridor. Ndonjëherë të afroresh në terren për të izoluar një vatër. Ndonjëherë të mbështesësh nga toka ndërhyrjen e helikopterit. Dhe shpesh, të gjitha këto bëhen njëkohësisht.

Një betejë që kërkon bashkëpunim

Zjarret nuk njohin kufij administrativë. Për këtë arsye, as përgjigjia ndaj tyre nuk mund të jetë e fragmentuar.

Në terren veprojnë së bashku **Forcat e Armatosura, zjarrfikësit, strukturat vendore, shërbimi pyjor dhe vullnetarët**. Secili ka detyrën e vet, por qëllimi është i përbashkët. Në këto momente, koordinimi është po aq i rëndësishëm sa edhe guximi. Një vatër e izoluar sot është një rrezik i shmangur nesër. Një korridor i hapur mund të ndalojë përparimin e flakëve. Një ndërhyrje e saktë nga ajri mund t'u japë forcave në tokë mundësinë për ta përfunduar operacionin. Prandaj, çdo veprim është pjesë e një zinxhiri më të madh.

NJË PAMJE QË FLET

Tymi mbulon pyllin. Flakët nuk duken gjithmonë nga larg, por rreziku është aty. Mbi pemë shfaqet helikopteri, ndërsa nga toka një efektiv ndjek ndërhyrjen.

Kjo pamje është më shumë se një fotografi nga një operacion. Është një dëshmi e **gatishmërisë, përkushtimit dhe sakrificës së njerëzve që përballen me emergjencën në terren**. Në një ditë vere, kur temperaturat dhe kushtet atmosferike e bëjnë më të vështirë kontrollin e flakëve, ata janë në vijën e parë.

Jo për spektakël.

Jo për duartrokitje.

Por sepse **aty kërkohet shërbimi i tyre.**

Dhe pikërisht ky është kuptimi i uniformës: të jesh aty kur vendi ka nevojë.

Nga toka dhe ajri, një mision i vetëm: të ndalet zjarri, të mbrohet jeta, të ruhet Shqipëria.



Nga toka, mbështesim çdo mision në ajër

Baza Ajrore e Kuçovës, nyja logjistike që mban në gatishmëri mjetet ajrore të angazhuara në operacionet kundër zjarreve

Në operacionet për përballimin e situatës së zjarreve në vend, ndërhyrja nga ajri është vetëm një pjesë e misionit. Pas çdo fluturimi qëndron një strukturë e tërë mbështetëse, e cila siguron furnizimin, përgatitjen dhe rikthimin e mjeteve ajrore në zonat e operacionit.

Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim po luan **Baza Ajrore e Kuçovës**, e cila ka vënë në dispozicion infrastrukturën dhe kapacitetet e saj logjistike për mbështetjen e mjeteve ajrore të angazhuara në luftën kundër zjarreve.

Nga kjo bazë furnizohen **katër helikopterët e angazhuar në operacion**, si dhe **dy avionët “Air Tractor”**. Pas furnizimit dhe përgatitjeve të nevojshme, mjetet ajrore rikthehen në zonat e zjarreve për të vijuar ndërhyrjen nga ajri.

Një cikël i pandërprerë mbështetjeje
Çdo ulje në Kuçovë është pjesë e një cikli operacional që përsëritet gjatë gjithë misionit: **ulje, furnizim, përgatitje dhe rikthim në operacion**.

Në këtë zinxhir, koha ka rëndësi të veçantë. Sa më shpejt të përfundojë procesi i furnizimit dhe përgatitjes, aq më shpejt mjetet ajrore mund të rikthehen mbi vatrat e zjarrit.

Pas këtij procesi qëndron personeli i Bazës Ajrore, i cili punon pa ndërprerje për të garantuar mbështetjen logjistike dhe gatishmërinë e mjeteve ajrore.

Në një operacion ku çdo minutë është e rëndësishme, **puna në tokë është po aq vendimtare sa ndërhyrja në ajër**. Helikopteri që ngrihet drejt një vatre zjarri duhet të ketë furnizimin e nevojshëm; avioni që rikthehet nga misioni duhet të jetë gati për fluturimin e radhës.

Kështu, ndërhyrja ajrore mbështetet nga një mekanizëm i organizuar në tokë, ku çdo efektiv, çdo mjet dhe çdo proces ka një rol të përcaktuar.

Pas çdo fluturimi, një ekip në tokë
Pamja e mjeteve ajrore që ngrihen nga Kuçova drejt zonave të përfshira nga zjarret është vetëm pjesa më e dukshme e këtij operacioni.

Në pistë dhe në strukturat mbështetëse të bazës vijon një tjetër mision: **të mbahet në gatishmëri flota ajrore e angazhuar në operacion**.

Personeli punon në ritëm të pandërprerë, duke siguruar që mjetet të furnizohen dhe të rikthehen sa më shpejt në detyrë. Është një punë që kërkon profesionalizëm, koordinim dhe përkushtim, sepse pas çdo ndërhyrjeje ajrore vjen menjëherë përgatitja për misionin tjetër.

Në këtë mënyrë, **Baza Ajrore e Kuçovës është shndërruar**



në një pikë kyçe të mbështetjes së operacioneve ajrore kundër zjarreve.

Nga toka drejt misionit
Operacioni kundër zjarreve është një përpjekje e



përbashkët ku ndërthuren kapacitetet ajrore, forcat në terren dhe strukturat mbështetëse.

Nga njëra anë janë efektivët që përballen drejtpërdrejt me flakët. Nga ana tjetër janë ekuipazhet që ndërhyjnë nga ajri. Dhe pas tyre qëndron personeli që siguron që mjetet ajrore të jenë gjithmonë të gatshme për misionin e radhës.

Nga toka mbështesim çdo mision në ajër.
Kjo është puna e heshtur, por thelbësore, e Bazës Ajrore të Kuçovës në këto ditë të vështira: të sigurojë që çdo helikopter dhe çdo avion i angazhuar në operacion të rikthehet sa më shpejt atje ku nevojitet – **mbi vatrat e zjarrit, në mbrojtje të njerëzve, banesave dhe pasurive natyrore të vendit**.



Kontrolle në ujërat e Himarës për zbatimin e rregullave të lundrimit dhe garantimin e sigurisë së jetës

Roja Bregdetare, në bashkëpunim me **Policinë Kufitare** dhe Migracionit, zhvilloi një operacion të përbashkët në ujërat e Himarës, me fokus rritjen e sigurisë lundimore dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi.

Në kuadër të operacionit, ekipi i përbashkët i anijes së Rojës Bregdetare **“BUTRINTI” P-134** dhe Stacionit të Policisë Kufitare dhe Migracionit Himarë kreu kontrolle dhe verifikime të mjeteve lundruese, duke u përqendruar veçanërisht në **dokumentacionin e mjeteve dhe pajisjet e sigurisë në bord**.

Gjatë operacionit u kontrolluan **25 mjete lundruese**, ndërsa për **6 prej tyre** u morën masa administrative për shkelje të konstatuara, konkretisht për mungesë dokumentacioni dhe tejkalim të kapaciteteve mbajtëse të lejuara.

Kontrollet synojnë jo vetëm evidentimin dhe ndëshkimin e shkeljeve, por mbi të gjitha **parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën e qytetarëve dhe pushuesve në det**. Respektimi i kapaciteteve të mjeteve lundruese, pajisja me mjetet e nevojshme të sigurisë dhe pajisja me dokumentacionin përkatës janë elementë thelbësorë për një sezon turistik të sigurt.

Bashkëpunimi ndërmjet Rojës Bregdetare dhe Policisë Kufitare e Migracionit përbën një komponent të rëndësishëm të kontrollit dhe monitorimit të hapësirës detare, veçanërisht gjatë sezonit turistik, kur intensifikohet ndjeshëm lëvizja e mjeteve lundruese.

Operacionet e përbashkëta do të vijojnë gjatë gjithë sezonit turistik, me synim **garantimin e sigurisë së jetës në det, respektimin e rregullave të lundrimit dhe zbatimin e ligjshmërisë detare**.

Siguria në det është përgjegjësi e përbashkët, kontrolli, parandalimi dhe respektimi i rregullave janë garancia për një sezon turistik të sigurt.

Roja Bregdetare dhe Policia Kufitare, operacion të përbashkët për sigurinë në det



Riviera Shqiptare, nga ëndrra e brezave te realiteti i një Shqipërie që sot e zgjedh bota

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një gji të vogël bregdetar dëgjohen njëherazi mbi tetë gjuhë të huaja. Dikur shqiptarët ëndërronin të pushonin në brigjet e botës; sot bota vjen të pushojë në brigjet tona.

Shpesh na ndodh të shohim pamje që të bëjnë të ndalesh për pak çaste, të shikosh përreth dhe të mendosh se sa shumë ka ndryshuar koha.

Një prej tyre është kjo: **një gji i vogël i Rivierës Shqiptare, një ditë vere, plazhi plot njerëz dhe përreth teje dëgjohen njëherazi mbi tetë gjuhë të huaja.** Italianë, gjermanë, francezë, anglezë, grekë, polakë, çekë, holandezë e vizitorë nga vende të tjera të Europës e më tej. Në të njëjtin breg, nën të njëjtin diell, pranë të njëjtit det.

Dhe mes gjithë këtyre gjuhëve dëgjohet ajo, magjikja, shqipja jonë.

Për një shqiptar që e ka parë Rivierën ndër vite, kjo nuk është thjesht një pamje e bukur turistike. **Është një nga ato pamje që të kujtojnë se një ëndërr e dikurshme është kthyer në realitet.**

Dikur ne shikonim në televizor brigjet e Italisë, Greqisë, Kroacisë, Spanjës apo vendeve të tjera turistike të Europës dhe imagjinonim se si do të ishte të kalonim pushimet atje. Sot, në shumë prej këtyre vendeve, shqiptarët janë turistë të zakonshëm, ndërsa në brigjet tona shohim gjithnjë e më shumë njerëz nga e gjithë bota që kanë zgjedhur Shqipërinë për pushimet e tyre.

Kjo është një pamje që duhet ta shohim edhe si një histori suksesi të vendit tonë.

Kur bota zbret në brigjet shqiptare

Riviera Shqiptare ka qenë gjithmonë aty. Deti ka qenë po ai, malet po ato, gjelbërimi, shkëmbinjtë, gjiret dhe perëndimet e diellit po aq të bukura.

Ajo që ka ndryshuar është **vëmendja e botës ndaj saj.**

Sot emrat e Dhërmiut, Himarës, Borshit, Qeparoit, Jalës, Palasës, Lukovës, Sarandës e shumë vendeve të tjera, nuk janë më vetëm emra të njohur për shqiptarët. Ata janë bërë destinacione të kërkuara nga turistët e huaj.

Në shumë prej tyre mund të ulesh në një tavolinë dhe të dëgjosh disa gjuhë njëherazi. Në plazh, në restorant, në shëtitore apo në një hotel, njerëzit vijnë nga vende të ndryshme dhe ndajnë të njëjtën dëshirë: të shijojnë detin, diellin, natyrën dhe mikpritjen.

Është një Shqipëri që dikur mezi e imagjinonim.

Sot po e jetojmë.

Një përvojë personale

Kam pasur fatin ta përjetoj vetë këtë ndjesi.

Në një nga këto gjire të bukura, duke pushuar pranë njerëzve të ardhur nga vende të ndryshme të botës, e kupton se sa e veçantë është ajo që po ndodh.

Nuk është thjesht fakti që plazhi është mbushur me turistë.

Është **ndjenja se je në një vend që po zbulohet nga bota.**

Dikush pranë teje flet italisht. Pak më tej dëgjon gjermanisht. Një familje tjetër komunikon në anglisht. Diku tjetër dëgjon frëngjisht, polonisht apo greqisht. Fëmijët luajnë



në breg pa pyetur se nga cili vend vijnë shokët e rinj të lojës. Të rriturit bisedojnë, qeshin, fotografojnë detin dhe perëndimin.

Në atë çast, gjuha nuk është më pengesë.

Deti i bashkon të gjithë.

Dhe Shqipëria bëhet vendi ku këta njerëz po krijojnë kujtime.

Për mua, si shqiptare, kjo ka një emocion të veçantë. Sepse e di se sa larg jemi nga koha kur udhëtimi jashtë vendit ishte një ëndërr për shumë prej nesh. Sot, ndërsa ne vazhdojmë të udhëtojmë e të njohim botën, edhe bota ka nisur të vijë tek ne.

Turizmi, një tjetër fytirë e Shqipërisë

Rritja e turizmit nuk duhet parë vetëm në numra. Pas çdo turisti që vjen ka një histori.

Një familje që ka zgjedhur Shqipërinë për pushimet e saj. Një çift që ka parë fotografitë e Rivierës në internet dhe ka vendosur ta vizitojë. Një grup të rinjsh që duan të njohin një vend të ri. Një udhëtar që pas një eksperience të bukur do t'u tregojë miqve të tij se Shqipëria ia vlen të vizitohet.

Kështu ndërtohet imazhi i një vendi.

Dhe Shqipëria po ndërton një imazh të ri.

Për shumë vite vendi ynë ishte për botën një hapësirë pak e njohur, ndoshta edhe misterioze. Sot, Shqipëria është gjithnjë e më shumë pjesë e hartës turistike europiane.

Riviera është një nga kartëvizitat më të bukura të kësaj Shqipërie të re.

Por turizmi është edhe një provë.

Sepse sa më shumë të njohur të bëhemi, aq më e madhe bëhet përgjegjësia jonë për të ruajtur atë që kemi.

Bukuria që duhet mbrojtur

Nëse sot turistët vijnë për detin, nesër do të vijnë përsëri vetëm nëse deti mbetet i pastër. Nëse vijnë për natyrën, duhet ta ruajmë natyrën. Nëse vijnë për autenticitetin, nuk duhet ta humbasim atë në emër të një zhvillimi pa kufij.

Riviera shqiptare ka nevojë për zhvillim, por mbi të gjitha ka nevojë për **zhvillim të mençur dhe të qëndrueshëm.**

Duhet të ndërtojmë, por pa shkatërruar. Duhet të presim më shumë turistë, por duke ruajtur cilësinë. Duhet të fitojmë nga turizmi, por duke menduar edhe për brezat që do të vijnë.

Sepse bukuria e Rivierës nuk është krijuar nga ne.

Ne e kemi marrë si një pasuri të çmuar nga brezat para nesh dhe kemi detyrimin t'ua dorëzojmë brezave të ardhshëm po aq të bukur.

Nga pushimet shqiptare te pushimet e botës në Shqipëri

Ndoshta ky është ndryshimi më i madh që mund të shohim me sytë tanë. Dikur bregdeti shqiptar ishte kryesisht vendi ku shqiptarët shkonin për pushime. Sot është një vend ku pushojnë shqiptarë dhe të huaj bashkë. Kjo është më shumë se një ndryshim turistik. Është një ndryshim në mënyrën se si Shqipëria shihet nga jashtë dhe, ndoshta, edhe në mënyrën se si ne shqiptarët e shohim vendin tonë.

Kur një i huaj udhëton mijëra kilometra për të ardhur në brigjet tona, kjo duhet të na bëjë të reflektojmë për vlerën e asaj që kemi.

Ndonjëherë ne që jetojmë këtu mësohemi me bukurinë dhe nuk e shohim më me të njëjtët sy. Turisti e sheh ndryshe. Ai ndalet te ngjyra e detit, te malet që zbresin drejt bregut, te ushqimi, te fshatrat, te rrugët e vjetra, te mikpritja, te perëndimi i diellit.

Ai na kujton se çfarë pasurie kemi.

Një Shqipëri që po e njeh bota

Në një gji të vogël të Rivierës, mbi tetë gjuhë të huaja mund të dëgjohen në të njëjtën kohë.

Është një pamje e thjeshtë, por me një simbolikë të madhe. Ajo tregon se Shqipëria nuk është më vetëm një vend që shqiptarët duan ta njohin e ta shijojnë.

Është një vend që bota po e zgjedh.

Dhe kjo duhet të na bëjë krenarë, por jo të vetëkënaqur.

Krenarë për bukurinë e vendit. Mirënjohës për natyrën që kemi. Të përgjegjshëm për mënyrën se si do ta zhvillojmë. Sepse turizmi mund të sjellë të ardhura, vende pune dhe zhvillim ekonomik, por mund të sjellë edhe diçka tjetër: **një Shqipëri më të hapur me botën.**

Në brigjet tona sot takohen njerëz të kombeve të ndryshme. Ata sjellin gjuhët, kulturat dhe historitë e tyre, ndërsa ne u ofrojmë detin, natyrën, ushqimin dhe mikpritjen tonë. Dhe në fund të pushimeve, secili largohet me diçka.

Ne mbajmë kujtimin e takimeve.

Ata marrin me vete një copëz Shqipërie.

Ndoshta ky është kuptimi më i bukur i turizmit: **të udhëtosh për të njohur botën dhe të kuptosh se bota ka ardhur edhe te dera jote.**

Dikur një ëndërr, sot një realitet

Teksa qëndroj në breg dhe dëgjoj gjuhë të ndryshme që përzihen me shqipen, më vjen natyrshëm të mendoj për vitet që kanë kaluar. Për kohën kur brigjet e huaja na dukeshin larg.

Për kohën kur udhëtimi ishte privilegj dhe pushimet jashtë vendit një ëndërr për shumë shqiptarë. Sot, historia ka marrë një tjetër kthesë.

Shqiptarët udhëtojnë nëpër botë, por edhe bota ka ardhur të pushojë në Shqipëri.

Dhe kjo është një nga pamjet më të bukura të Shqipërisë së sotme.

Një gji i vogël.

Një det i kaltër.

Një diell i madh vere.

Mbi tetë gjuhë të huaja që përzihen në ajër.

Dhe në mes tyre, shqipja jonë.

Një ëndërr e brezave të shkuar, që sot po e jetojmë si realitet.

Riviera Shqiptare nuk është më vetëm një pasuri e jona.

Ajo është bërë një dritare përmes së cilës bota po njeh Shqipërinë.

Dhe detyra jonë është që kjo dritare të mbetet e hapur, e pastër dhe e bukur për shumë breza që do të vijnë.





KRISTAQ XHARO – NJË JETË NË UNIFORMË, NJË MENDJE NË SHËRBIM TË DIJES DHE ATDHEUT

PORTRETE QË MERITOJNË TË MBETEN NË KUJTESË

Në faqet e **Shtypit Ushtarak** kanë zënë dhe do të zënë vend njerëz që me jetën, shërbimin dhe veprën e tyre kanë lënë gjurmë në historinë e Forcave të Armatosura Shqiptare. Për ne, ruajtja e kësaj kujtese nuk është thjesht një detyrë botuese; është pjesë e misionit për të përcjellë te brezat përvojën, vlerat dhe kontributin e njerëzve që i kanë shërbyer vendit me përkushtim.

Në këtë kuadër, e sjellim për lexuesin portretin **“Kristaq Xharo – një jetë në uniformë, një mendje në shërbim të dijes dhe atdheut”**, të përgatitur nga **Agim Lika**, ushtarak, poet, historian dhe studiues. Është një portret që nuk kufizohet në një renditje të thjeshtë të detyrave, gradave apo arritjeve profesionale, por përpqet të depërtojë te njeriu, te oficeri, pedagogu dhe studiuesi që qëndron pas uniformës. Përmes këtij shkrimi, autori sjell para lexuesit figurën e **Prof. Dr. Kristaq Xharos**, kolonel në rezervë dhe ushtarak karriere, duke ndjekur rrugëtimin e tij në shërbim të Forcave të Armatosura, të arsimit ushtarak dhe të mendimit profesional në fushën e sigurisë, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

Vlera e këtij portreti qëndron edhe te këndvështrimi i autorit. **Agim Lika nuk shkruan për një koleg nga largësia e një vëzhguesi**, por si një ushtarak që ka përjetuar vetë

përgjegjësinë e uniformës, disiplinën, vështirësitë dhe krenarinë e shërbimit. Kjo e bën rrëfimin më njerëzor dhe njëkohësisht më të besueshëm.

Redaksia e Shtypit Ushtarak e vlerëson këtë bashkëpunim si një **kontribut të çmuar në dokumentimin e kujtesës profesionale dhe njerëzore të Forcave të Armatosura**. Portrete të tilla na ndihmojnë të mos e shohim historinë ushtarake vetëm përmes institucioneve dhe ngjarjeve, por edhe përmes njerëzve që i kanë dhënë asaj përmbajtje, dije dhe përkushtim.

Njëkohësisht, ky shkrim është edhe një ftesë për studiuesit, ushtarakët dhe autorët e brezave të ndryshëm që të sjellin në faqet tona portrete të tjera të personaliteteve të ushtrisë shqiptare, duke pasuruar kështu arkivin e shkruar të **Shtypit Ushtarak**.

Redaksia i shpreh mirënjohjen autorit Agim Lika për këtë portret dhe vlerëson figurën e Prof. Dr. Kristaq Xharos si pjesë të një tradite profesionale ku uniforma, dija dhe shërbimi ndaj atdheut ndërthuren në një rrugëtim të vetëm.

Sepse historia e ushtrisë nuk shkruhet vetëm me data e ngjarje. **Ajo shkruhet edhe me portretet e njerëzve që i dhanë asaj një emër, një mendim dhe një trashëgimi.**

Portret i një oficeri, pedagogu dhe strategu shqiptar



NGA AGIM LIKA,
ushtarak, poet, historian dhe studiues

Në historinë moderne të Forcave të Armatosura Shqiptare ka personalitete, rrugëtimi i të cilëve nuk mund të përmblihet vetëm përmes detyrave që kanë mbajtur, gradave që kanë fituar apo institucioneve ku kanë shërbyer. Ata përfaqësojnë më shumë se një karrierë individuale: mishërojnë një epokë, një shkollë mendimi dhe një kulturë profesionale që ka ndikuar në formimin e brezave dhe në zhvillimin e institucioneve të mbrojtjes e të sigurisë kombëtare.

Ka njerëz për të cilët mund të shkruash duke renditur data, grada, funksione dhe tituj. Por ka edhe personalitete për të cilët kronologjia, sado e

pasur dhe domethënëse të jetë, nuk mjafton. Jeta dhe vepra e tyre nuk maten vetëm me vitet e shërbimit, me përgjegjësitë që kanë mbajtur apo me vlerësimet që kanë marrë, por, mbi të gjitha, me gjurmën që kanë lënë në institucionet ku kanë shërbyer, në mendimin profesional që kanë zhvilluar dhe në brezat që kanë formuar.

Një prej këtyre personaliteteve është Prof. Dr. Kristaq Xharo, kolonel në rezervë, ushtarak karriere, pedagog, studiues dhe njohës i çështjeve të sigurisë, mbrojtjes dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Jeta dhe veprimtaria e tij përfaqësojnë një ndërthurje organike ndërmjet disiplinës ushtarake dhe kërkimit shkencor, përvojës së komandimit dhe përgjegjësisë akademike, shërbimit kombëtar dhe përfaqësimit ndërkombëtar.

Për mua, si ushtarak dhe studiues, që kam veshur për dekada të njëjtën uniformë dhe kam njohur nga afër peshën e detyrës, disiplinën e repartit, përgjegjësinë e komandimit dhe krenarinë e shërbimit ndaj atdheut, të shkruaj për një personalitet shumëdimensional si Prof. Dr. Kristaq Xharo nuk ka qenë një ndërmarrje e lehtë. Kompleksiteti i figurës së tij, shumëllojshmëria e kontributeve dhe shtrirja e gjerë e veprimtarisë profesionale, pedagogjike e shkencore kërkojnë jo vetëm vëmendje dokumentare dhe objektivitet analitik, por edhe një shkallë të lartë përgjegjësie intelektuale dhe morale.

Ne, ushtarakët, e dimë mirë se çfarë qëndron pas një grade. Pas çdo ylli, pas çdo spalete dhe pas çdo detyre të lartë qëndrojnë vite pune e përkushtimi, net pa gjumë, largime nga familja, përgjegjësi të heshtura dhe vendime që, jo rrallë, duhen marrë pa pasur luksin e hezitimit. Për këtë arsye, vlerësimi i një karriere ushtarake nuk mund të kufizohet vetëm në hierarkinë e funksioneve apo në kronologjinë e gradave; ai duhet të depërtojë në përmbajtjen e shërbimit, në cilësinë e kontributit dhe në ndikimin që individi ka ushtruar mbi institucionin dhe njerëzit.

Prandaj, kur shkruaj për Prof. Dr. Kristaq Xharon, nuk shoh vetëm profesorin, kolonelin, drejtuesin apo ekspertin e sigurisë. Shoh edhe kolegun e armës: ushtarakun që për dekada

mbajti mbi supe përgjegjësinë e uniformës dhe që, edhe pas përfundimit të shërbimit aktiv, nuk u largua nga misioni i tij intelektual, profesional dhe qytetar. Sepse uniforma mund të hiqet një ditë, por vlerat që ajo kultivon — disiplina, përgjegjësia, ndjenja e detyrës dhe përkushtimi ndaj atdheut — mbeten pjesë e ndërgjegjes së ushtarakut për gjithë jetën.

Në këtë kuptim, studimi i figurës dhe i veprimtarisë së Prof. Dr. Kristaq Xharos nuk synon të mbetet vetëm brenda kufijve të rrëfimit biografik apo të dokumentimit të një karriere të gjatë dhe të pasur. Ai përbën një përpjekje për të interpretuar një trajektore të spikatur profesionale, ushtarake dhe akademike, si dhe për të analizuar një model të veçantë të ndërveprimit ndërmjet profesionit ushtarak, arsimit, kërkimit shkencor dhe mendimit strategjik.

Karakterit shumëdimensional i këtij profili e bën analizën metodologjiksht komplekse dhe sfiduese, por njëkohësisht i jep asaj një rëndësi të veçantë për studimin e zhvillimit historik dhe institucional të arsimit ushtarak, të kulturës profesionale dhe të mendimit strategjik shqiptar.

Në këtë perspektivë, analiza e kontributit të Prof. Dr. Kristaq Xharos synon të evidentojë marrëdhënien ndërmjet përvojës individuale, zhvillimit institucional dhe transformimeve më të gjera që kanë karakterizuar fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare në Shqipëri.

Figura e tij mund të lexohet, kështu, jo vetëm si historia e një karriere individuale, por edhe si pjesë e historisë së zhvillimit të institucioneve ushtarake dhe akademike shqiptare në një periudhë transformimesh të thella. Përvoja e fituar në shërbimin ushtarak, përgjegjësitë drejtuese, angazhimi pedagogjik dhe kërkimi shkencor krijojnë një profil në të cilin praktika dhe teoria nuk qëndrojnë të ndara, por ushqejnë dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

Pikërisht në këtë ndërthurje të shërbimit ushtarak, dijes akademike, kërkimit shkencor dhe mendimit strategjik qëndron edhe veçantia e figurës së Prof. Dr. Kristaq Xharos: ajo e një ushtaraku që përvojën e shndërroi në dije, dijen në kontribut dhe kontributin në një trashëgimi profesionale e intelektuale për brezat.

RRËNJËT KU NIS NJË RRUGËTIM

Kristaq Xharo lindi më 17 gusht 1959, në Gradishtë të Lushnjës, në një familje ku puna, ndershmëria dhe dashuria për vendin nuk ishin fjalë të mëdha, por mënyrë jetese. Babai i tij kishte qenë pjesëtar i Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në radhët e Brigadës XVI Sulmuese. Kështu, historia e shërbimit ndaj vendit kishte hyrë në familjen e tij përpara se ai vetë të vishte uniformën.

Ndoshta zgjedhjet më të rëndësishme të jetës lindin pikërisht aty: në heshhtjen e shtëpisë, në rrëfimet e prindërve, në shembullin e tyre dhe në kujtesën që një brez ia përcjell tjetrit. Në vitin 1974 përfundoi shkollën tetëvjeçare “Mihal Nako” në Fierseman me rezultate të shkëlqyera. Më pas erdhi ajo zgjedhje që do të përcaktonte gjithë jetën e tij: rruga e ushtrisë.

Në vitin 1978 përfundoi Shkollën e Mesme Ushtarake “Skënderbej”. Për ne që kemi kaluar nëpër atë shkollë, emri Shkollës “Skënderbej” nuk është thjesht emri i një institucioni arsimor. Është një pjesë e jetës sonë. Është kujtesa e rinisë, e zgjimit me disiplinën ushtarake, e shoqërisë së farkëtuar në vështirësi dhe e ëndrrës për t’u bërë oficerë. Aty mësoje se uniforma nuk ishte privilegj. Ishte përgjegjësi. Aty fillonte të

formohej oficeri, por mbi të gjitha fillonte të formohej njeriu që duhej të dinte të qëndronte drejt përballë detyrës.

NGA BANKAT E SHKOLLËS NË AUDITORËT E AKADEMISË

Në periudhën 1979–1982, Prof. Dr. Kristaq Xharo kreu studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve në Tiranë dhe u titullua oficer i Forcave të Armatosura. Por rruga e tij do të merrte shpejt një drejtim të veçantë.

Në vitin 1983 u emërua pedagog në Katedrën e Zjarrit të Akademisë Ushtarake. Të jesh oficer është përgjegjësi. Të përgatitësh oficerë është një përgjegjësi edhe më e madhe. Sepse pedagogu ushtarak nuk jep vetëm njohuri. Ai formon mënyrën e të menduarit të atyre që një ditë do të drejtojnë njerëz, reparte dhe struktura. Ai ndikon në karakterin profesional të brezave që vijnë pas tij.

Për rreth dymbëdhjetë vjet, Kristaq Xharo u përkushtua pikërisht këtij misioni. Në auditorët e Akademisë Ushtarake ai nuk ishte thjesht lektor. Ishte edukator i oficerëve të rinj, kërkues ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve, një pedagog që e shihte dijen si pjesë të pandashme të profesionit ushtarak. Dhe kjo është një e vërtetë që ne ushtarakët e njohim mirë: një ushtri nuk bëhet e fortë vetëm nga armët që zotëron. Ajo bëhet e fortë nga njerëzit që dinë të mendojnë.

NJË OFICER SHQIPTAR PËRBALLË BOTËS QË PO NDRYSHONTE

Vitet ‘90 sollën ndryshime të mëdha. Shqipëria ndryshonte. Ushtria ndryshonte. Bota kishte hyrë në një epokë të re. Në atë kohë duhej jo vetëm të kishe përvojë, por edhe guximin për të mësuar përsëri. Prof. Dr. Kristaq Xharo e pati këtë aftësi. Në vitin 1995 përfundoi Kolegjin e Shtatmadhorisë në Vjenë të Austrisë. Më pas, gjatë viteve 1997–1999, ndoqi Kolegjin e Komandave dhe Shtabeve në Kansas, SHBA.

Nga një sistem ushtarak i mbyllur, ai hyri në kontakt të drejtpërdrejtë me konceptet bashkëkohore të komandimit, strategjisë dhe sigurisë. Nuk ishte një kalim i zakonshëm. Ishte kalimi nga një epokë në një tjetër. Dhe Prof. Dr. Kristaq Xharo ishte ndër ata oficerë shqiptarë që patën mundësinë, por edhe përgjegjësinë, të sillnin në vend një mënyrë të re të menduari për mbrojtjen dhe sigurinë. Ai nuk u kthye vetëm me diploma. U kthye me përvojë. Me ide. Me një horizont më të gjerë.

NË SHTABIN E PËRGJITHSHËM – ATY KU PËRGJEGJËSIA MERR PESHË TJETËR

Nga viti 1999 deri në vitin 2005 shërbeu në Drejtorinë e Operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ne që kemi shërbyer në strukturat e ushtrisë e dimë se puna e shtabit shpesh nuk duket. Ajo nuk ka gjithmonë ceremoninë e paradës. Nuk ka gjithmonë duartrokitje. Por pas çdo plani, çdo operacioni dhe çdo vendimi të rëndësishëm qëndrojnë orë të gjata pune, analiza, përgjegjësi dhe përkushtim. Prof. Dr. Kristaq Xharo shërbeu pikërisht në një periudhë kur Forcat e Armatosura Shqiptare po kalonin një nga transformimet më të thella të historisë së tyre. Ishte koha kur duhej të ndryshonin strukturat, doktrinat dhe mentaliteti profesional. Dhe ai ishte pjesë e këtij transformimi.

NJË USHTARAK NË SHËRBIM TË PAQES DHE BASHKËPUNIMIT

Në vitet 2005–2007, Prof. Dr. Kristaq Xharo mori drejtimin

e Sekretariatit të procesit të Ministrave të Mbrojtjes të Europës Juglindore – SEDM. Nga fusha e pastër ushtarake, ai hyri më thellë në diplomacinë e sigurisë. Sepse oficeri modern nuk duhet të dijë vetëm si të përgatitet për luftën. Ai duhet të dijë edhe si të ndërtojë paqen. Në një rajon që kishte kaluar konflikte dhe ndarje

të dhimbshme, bashkëpunimi në fushën e sigurisë kishte një rëndësi të veçantë. Prof. Dr. Kristaq Xharo kontribuoi në këtë proces me përvojën e ushtarakut dhe maturinë e akademikut.

NË BRUKSEL, NË NJË KOHË HISTORIKE PËR SHQIPËRINË

Nga viti 2007 deri në vitin 2010 shërbeu si zëvendësshef i misionit të Shqipërisë pranë NATO-s në Bruksel. Ishte një periudhë historike. Shqipëria po ecte drejt realizimit të një prej objektivave të saj më të mëdha strategjike: anëtarësimit në NATO. Në ato vite, çdo përfaqësues shqiptar në strukturat e Aleancës mbante mbi supe jo vetëm përgjegjësinë e detyrës, por edhe peshën e përfaqësimit të një kombi që kërkonte vendin e tij në familjen euroatlantike.

Kristaq Xharo ishte aty. Në Bruksel. Në një nga qendrat më të rëndësishme të vendimmarrjes strategjike të botës. Dhe për një oficer shqiptar, nuk mund të ketë krenari më të madhe sesa të shohë flamurin e vendit të tij të ngrihet mes flamujve të aleatëve. Ai ishte pjesë e atij brezi ushtarakësh dhe diplomatësh që kontribuan në këtë rrugëtim historik.

KTHIMI TE AKADEMIA – KTHIMI TE MISIONI I DIJES

Në vitet 2010–2011, Prof. Dr. Kristaq Xharo mori drejtimin e Akademisë së Mbrojtjes. Kishte nisur dikur si pedagog. Tani kthehej si drejtues. Jeta, në një mënyrë të bukur dhe domethënëse, e sillte përsëri aty ku kishte filluar misioni i tij akademik. Në krye të Akademisë së Mbrojtjes, ai punoi për modernizimin e arsimit ushtarak dhe përafrimin e tij me standardet euroatlantike.

Më pas shërbeu si këshilltar për NATO-n pranë Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, drejtoi Departamentin e Lidershipit në Akademinë e Mbrojtjes dhe ishte shef i Planëzimit në Komandën e Forcave Tokësore. Çdo detyrë ishte një kapitull. Çdo kapitull, një përgjegjësi.

DITA KUR HIQET UNIFORMA

Në vitin 2015, Kolonel Kristaq Xharo doli në rezervë. Për çdo ushtarak, kjo është një ditë e veçantë. Vjen një moment kur uniformën që ke veshur për dekada duhet ta vendosësh në gardërobë. Por bashkë me të nuk mund të vendosësh kujtimet. Nuk mund të mbyllësh në një sirtar vitet e shërbimit. Nuk mund të harrosh shokët, kolegët, komandantët, vartësit, repartet, akademikët, ceremonitë dhe sfidat. Sepse ushtria, pasi bëhet pjesë e jetës sate, mbetet përgjithmonë brenda teje. Prof. Dr. Kristaq Xharo doli në rezervë si Kolonel, por nuk doli kurrë në rezervë nga shërbimi ndaj dijes.

PROFESORI QË VAZHDON MISIONIN

Që prej vitit 2015, ai vazhdoi rrugën e tij në auditorët universitarë, duke ligjëruar në Universitetin European të Tiranës në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të sigurisë. Uniformën e zëvendësoi me auditorin civil. Por misioni mbeti i njëjtë: të formojë njerëz, të ndajë përvojën, të nxisë mendimin kritik, t’u flasë brezave të rinj për sigurinë, historinë, strategjinë dhe interesin kombëtar. Sepse dijetari i vërtetë nuk e mban dijen për vete. Ai e kthen atë në trashëgimi.

NJË JETË E NDËRTUAR MBI DIJEN

Rrugëtimi akademik i Prof. Dr. Kristaq Xharos është po aq i pasur sa karriera e tij ushtarake. Nga shkollimi ushtarak në Shqipëri, te Kolegji i Shtatmadhorisë në Vjenë dhe Kolegji i Komandave dhe Shtabeve në Kansas; nga studimet në Histori në Universitetin e Tiranës deri te gradat dhe titujt shkencorë, ai ka ndërtuar një profil ku përvoja dhe teoria plotësojnë njëra-tjetrën.

Në vitin 1992 mori titullin “Kandidat i Shkencave”, në vitin 1994 gradën “Doktor i Shkencave”, në vitin 1995 titullin “Profesor i Asociuar”, ndërsa në vitin 2012 u titullua “Profesor Doktor”. Por titulli më i rëndësishëm i një pedagogu nuk shkruhet gjithmonë në një diplomë. Ai ruhet në kujtesën e studentëve. Në respektin e kolegëve. Në mendimin që lë pas.

KONTRIBUTI NË ZHVILLIMIN E MENDIMIT STRATEGJIK DHE TË KULTURËS SË SIGURISË

Një tjetër rezultat i rëndësishëm që del nga analiza e veprimtarisë akademike dhe profesionale të Profesor Dr. Kristaq Xharos lidhet me kontributin e tij në zhvillimin e mendimit strategjik dhe në konsolidimin e kulturës së sigurisë në Shqipëri. Nëpërmjet veprimtarisë pedagogjike, kërkimit shkencor, botimeve dhe analizave të specializuara, ai ka ndikuar në zgjerimin e mënyrës së konceptimit të sigurisë, duke e trajtuar atë jo vetëm si përgjegjësi të institucioneve të mbrojtjes, por si një çështje komplekse që kërkon vizion, dije, koordinim institucional dhe ndërgjegjësım shoqëror.

Në qasjen e tij, mendimi strategjik përfaqëson aftësinë për të analizuar të tashmen duke parashikuar prirjet dhe sfidat e së ardhmes. Kjo perspektivë merr rëndësi të veçantë në një mjedis sigurie të karakterizuar nga pasiguria,

ndryshimet e shpejta teknologjike, rivalitetet gjeopolitike dhe ndërthurja e kërcënimeve tradicionale me ato të natyrës hibride dhe jo tradicionale. Kontributi i Profesor Xharos qëndron pikërisht në aftësinë për t’i vendosur këto zhvillime në një kuadër të strukturuar analitik dhe për të nxitur një qasje më të thelluar ndaj planifikimit dhe vendimmarrjes strategjike.

Një vlerë e veçantë e veprimtarisë së tij lidhet me promovimin e kulturës së analizës dhe të debatit profesional. Ai ka vend të interpretimeve të ngushta ose të fragmentarizuara, ai ka nxitur shqyrtimin e problemeve të sigurisë në marrëdhëniet e tyre të ndërsjella, duke evidentuar se vendimmarrja strategjike kërkon njohjen e historisë, gjeopolitikës, marrëdhënieve ndërkombëtare, doktrinave ushtarake dhe transformimeve teknologjike. Kjo qasje ka rëndësi të veçantë për formimin e profesionistëve të sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilët duhet të jenë të aftë jo vetëm të reagojnë ndaj krizave, por edhe të parashikojnë zhvillimet dhe të ndërtojnë alternativa të qëndrueshme veprimi.

Në këtë kontekst, veprimtaria pedagogjike e Profesor Xharos përbën një komponent thelbësor të kontributit të tij. Përmes procesit të mësimdhënies dhe komunikimit akademik, ai ka ndikuar në formimin e brezave të ushtarakëve, studentëve dhe profesionistëve të fushës, duke transmetuar jo vetëm njohuri teorike, por edhe një mënyrë të menduari të mbështetur në analizë, argumentim dhe përgjegjësi profesionale. Ndikimi i një pedagogu dhe studiuesi nuk matet vetëm me numrin e botimeve apo të leksioneve të zhvilluara, por edhe me gjurmën intelektuale që lë te njerëzit që ka formuar. Pikërisht në këtë dimension, kontributi i Profesor Xharos merr një vlerë të qëndrueshme

dhe shumëfishuese.

Nga analiza rezulton gjithashtu se mendimi strategjik i promovuar prej tij mbështetet në ndërthurjen e përvojës kombëtare me standardet dhe zhvillimet euroatlantike. Në këtë mënyrë, çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë së Shqipërisë trajtohen në raport me përgjegjësitë kombëtare, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe nevojën për përshtatje të vazhdueshme ndaj një mjedisi sigurie në transformim. Kjo qasje kontribuon në forcimin e një kulture strategjike që nuk mbështetet vetëm në reagimin ndaj kërcënimeve, por në parandalimin, parashikimin dhe ndërtimin e qëndrueshmërisë institucionale.

Në planin e diskutimit shkencor, kontributi i Profesor Dr. Kristaq Xharos mund të vlerësohet si pjesë e procesit më të gjerë të zhvillimit të mendimit bashkëkohor shqiptar për sigurinë dhe mbrojtjen. Ai përfaqëson profilin e ushtarakut dhe akademikut që e ka shndërruar përvojën profesionale në objekt reflektimi dhe kërkimi shkencor. Kjo ndërthurje ndërmjet praktikës dhe teorisë i jep veprimtarisë së tij një karakter të veçantë, sepse njohuritë nuk mbeten vetëm në nivelin konceptual, por lidhen me problematika konkrete të institucioneve, politikave dhe strategjive të sigurisë.

Për rrjedhojë, mund të argumentohet se një nga kontributet më të rëndësishme të Profesor Dr. Kristaq Xharos është ndihmesa në krijimin dhe zhvillimin e një mendimi strategjik të orientuar nga analiza kritike, vizioni afatgjatë dhe përgjegjësia kombëtare. Nëpërmjet veprës së tij akademike, pedagogjike dhe profesionale, ai ka kontribuar në forcimin e kulturës së sigurisë dhe në formimin e një qasjeje më bashkëkohore ndaj sfidave të mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale.

NJË USHTARAK, NJË FIGURË E DIJES

Kur shohim rrugëtimin e Prof. Dr. Kristaq Xharos, shohim më shumë se një biografi të suksesshme. Shohim historinë e një brezi. Një brez që u formua në një sistem dhe u detyrua të ndërtonte një tjetër. Një brez që përjetoi ndryshimin e doktrinave, strukturave dhe aleancave. Një brez që e nisi karrierën në kushtet e Luftës së Ftohtë dhe e vazhdoi atë në strukturat euroatlantike.

Kristaq Xharo ishte jo vetëm dëshmitar i këtij transformimi. Ai ishte pjesë e tij. Si oficer. Si pedagog. Si drejtues. Si përfaqësues i Shqipërisë. Si studiues.

SI E NJOHA PROF. DR. KRISTAQ XHARON

Njohja ime me Prof. Dr. Kristaq Xharon nisi në vitin mësimor 1987–1988, kur unë isha student i vitit të parë në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, ndërsa ai pedagog. Në atë periudhë ishte i angazhuar me punën kërkimore për doktoraturën, të lidhur ngushtë me fushën e përgatitjes së zjarrit.

E kujtoj shpesh në poligonin e zjarrit, ku qëndronte me orë të tëra duke vëzhguar, matur dhe kryer llogaritje mbi qitjet praktike. Për ne studentët, poligoni ishte vendi ku mësonim mjeshtrinë e armës; për të, ishte një laborator i hapur kërkimi, ku teoria provohej dhe argumentohej përmes praktikës.

Atëherë, si student i ri, ndoshta nuk mund ta kuptoja plotësisht përmasën e asaj pune. Vite më vonë, kur rrugëtimi ushtarak na bëri kolegë, e vlerësova edhe më shumë seriozitetin, këmbënguljen dhe pasionin e tij për dijen. Sot, kur shkruaj për Prof. Dr. Kristaq Xharon, më rikthehet ajo pamje e viteve të largëta: pedagogu i përqendruar në poligon, gjithmonë në kërkim të një përgjigjeje më të saktë. Atëherë e shihja me sytë e studentit; më vonë pata nderin ta vlerësoja me respektin e kolegut dhe eprorit ushtarak.

PËRFUNDIME

Analiza e veprimtarisë profesionale, ushtarake, pedagogjike dhe shkencore të Prof. Dr. Kristaq Xharos evidenton një profil shumëdimensional, të ndërtuar mbi ndëreveprimin organik ndërmjet përvojës institucionale, veprimtarisë akademike, kërkimit shkencor dhe mendimit strategjik.

Rezultatet e studimit tregojnë se kontributi i tij nuk mund të vlerësohet në mënyrë të fragmentuar apo vetëm në raport me funksionet e veçanta të ushtruara gjatë karrierës, por kërkon një qasje të integruar, e cila merr në konsideratë vazhdimësinë ndërmjet formimit ushtarak, praktikës profesionale, mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Së pari, përvoja ushtarake përbën bazën profesionale mbi të cilën është zhvilluar veprimtaria e tij e mëvonshme pedagogjike dhe studimore. Njohja e drejtpërdrejtë e strukturave, proceseve dhe problematikave të institucionit ushtarak ka krijuar premisat për një trajtim të çështjeve të mbrojtjes dhe të sigurisë që ndërthur dimensionin teorik me përvojën praktike. Ky raport ndërmjet teorisë dhe praktikës përbën një nga elementet themelore në formimin dhe konsolidimin e profilit të tij akademik.

Së dyti, veprimtaria pedagogjike përfaqëson një nga dimensionet kryesore të kontributit të tij institucional dhe intelektual. Përmes mësimdhënies dhe angazhimit në proceset e formimit profesional, përvoja individuale është shndërruar në dije të sistematizuar, të interpretueshme dhe të transmetueshme. Në këtë mënyrë, ndikimi i veprimtarisë së tij shtrihet përtej ushtrimit të funksioneve konkrete dhe lidhet me formimin profesional e intelektual të studentëve, kursantëve dhe profesionistëve të fushës së mbrojtjes dhe të sigurisë.

Së treti, veprimtaria kërkimore dhe shkencore evidenton rëndësinë e analizës strategjike për kuptimin dhe interpretimin e zhvillimeve bashkëkohore të sigurisë. Në kushtet e transformimit të vazhdueshëm të mjedisit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, studimi i problematikave të sigurisë kërkon qasje ndërdisiplinore, aftësi analitike dhe vlerësim të ndërvarësisë ndërmjet faktorëve politikë, ushtarakë, ekonomikë, teknologjikë dhe shoqërorë. Kontributi i Prof. Dr. Kristaq Xharos në këtë fushë lidhet me trajtimin e këtyre problematikave nga perspektiva e mendimit strategjik dhe e interesave të sigurisë kombëtare.

Së katërti, ekspertiza në çështjet e sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale përbën një komponent të rëndësishëm të profilit të tij profesional dhe akademik. Analiza e veprimtarisë së tij evidenton një orientim drejt interpretimit sistematik të zhvillimeve të sigurisë, duke e vendosur dimensionin kombëtar në marrëdhënie të drejtpërdrejtë me dinamikat rajonale dhe proceset globale. Kjo qasje merr rëndësi të veçantë në studimet bashkëkohore të sigurisë, ku ndërvarësia ndërmjet niveleve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare është bërë gjithnjë e më e theksuar.

Së pesti, profili i analizuar evidenton modelin e oficerit–pedagogut–studiuesit, si një formë të veçantë të zhvillimit

profesional dhe intelektual në institucionet e mbrojtjes dhe të arsimit ushtarak. Ky model dëshmon se përvoja profesionale dhe veprimtaria akademike mund të krijojnë një marrëdhënie reciprokisht plotësuese: praktika ofron problematika, përvojë empirike dhe çështje për reflektim shkencor, ndërsa kërkimi dhe mësimdhënia kontribuojnë në sistematizimin, interpretimin dhe transmetimin e kësaj përvoje.

Së gjashti, rezultatet e analizës tregojnë se vlerësimi i ndikimit të një pedagogu dhe studiuesi nuk duhet të kufizohet vetëm në funksionet e ushtruara, titujt akademikë apo prodhimtarinë bibliografike. Një dimension thelbësor i këtij ndikimi lidhet me kontributin në formimin e kapitalit njerëzor, zhvillimin e kulturës profesionale, nxitjen e debatit akademik dhe konsolidimin e aftësive për analizë kritike dhe mendim strategjik.

Në tërësi, studimi evidenton se Prof. Dr. Kristaq Xharo përfaqëson një profil profesional dhe akademik shumëdimensional, në të cilin ndërthuren në mënyrë të qëndrueshme përvoja ushtarake, veprimtaria pedagogjike, kërkimi shkencor dhe ekspertiza në fushën e sigurisë. Rëndësia e këtij profili qëndron pikërisht në vazhdimësinë ndërmjet këtyre dimensioneve dhe në mënyrën se si përvoja profesionale është shndërruar në dije, ndërsa dija është transmetuar, zhvilluar dhe vënë në funksion të formimit profesional dhe të analizës strategjike.

Nga kjo perspektivë, rasti i Prof. Dr. Kristaq Xharos paraqet interes të veçantë për studimin e zhvillimit të arsimit ushtarak dhe të mendimit strategjik shqiptar. Ai ofron një shembull domethënës të marrëdhënies ndërmjet karrierës ushtarake dhe veprimtarisë akademike, si dhe të rolit që individët me përvojë të integruar profesionale dhe shkencore mund të luajnë në zhvillimin dhe konsolidimin e institucioneve të mbrojtjes, arsimit dhe sigurisë.

Si përfundim, kontributi i Prof. Dr. Kristaq Xharos mund të konceptualizohet si një proces i vazhdueshëm i transformimit të përvojës profesionale në dije të sistematizuar dhe të transmetueshme. Rëndësia e veprimtarisë së tij nuk qëndron vetëm në trajektoren individuale të një karriere të gjatë dhe të pasur, por edhe në kontributin e dhënë për zhvillimin e kulturës profesionale, arsimit ushtarak, studimeve të sigurisë dhe mendimit strategjik shqiptar. Në këtë kuptim, figura e tij përfaqëson një rast studimor me vlerë për të kuptuar mënyrën se si përvoja e akumuluar në institucionin ushtarak mund të shndërrohet në kapital intelektual dhe akademik, ndërsa dija e prodhuar mund t’u rikthehet institucioneve dhe brezave në formën e mësimdhënies, kërkimit, analizës dhe mendimit strategjik.

Studimi i mëtejshëm i veprimtarisë së Prof. Dr. Kristaq Xharos, i mbështetur në analizën sistematike të botimeve, dokumentacionit arkivor, veprimtarisë pedagogjike dhe burimeve të tjera relevante, do të mundësonte një vlerësim edhe më të plotë të kontributit të tij në zhvillimin e arsimit ushtarak, studimeve të sigurisë dhe mendimit strategjik në Shqipëri.

EPILOG

UNIFORMA QË MBETET NË SHPIRT
Duke shkruar këto radhë për një koleg të armës, më vjen natyrshëm të mendoj për atë që mbetet në fund të një karriere të gjatë ushtarake. Gradat dorëzohen. Detyrat u kalojnë të tjerëve. Zyrat ndryshojnë drejtues. Uniforma vendoset me kujdes mes kujtimeve. Por një gjë mbetet. Nderi me të cilin ke shërbyer. Dhe ky është, ndoshta, dekorimi më i madh që mund të marrë një ushtarak.

Prof. Dr. Kristaq Xharo, Kolonel në rezervë, përfaqëson një jetë në të cilën uniforma dhe libri kanë ecur krah për krah; ku disiplina e oficerit është bashkuar me kërkimin e studiuesit; ku përvoja e komandimit është plotësuar nga përgjegjësia e pedagogut; ku shërbimi ndaj Forcave të Armatosura është shndërruar natyrshëm në shërbim ndaj dijes, mendimit dhe formimit të brezave.

Nga Gradishta e Lushnjës deri në Bruksel, nga bankat e Shkollës së Mesme Ushtarake “Skënderbej” deri në auditorët e akademive të Vjenës dhe Kansasit, nga strukturat e Shtabit të Përgjithshëm deri në drejtimin e Akademisë së Mbrojtjes, rrugëtimi i tij është historia e një njeriu që nuk reshti së mësuari, së kërkuari dhe së shërbyeri. Si ushtarak, e di se pas çdo karriere të gjatë ka shumëçka që nuk shkruhet në biografi.

Ka lodhje që nuk përmenden.
Ka sakrifica që nuk numërohen.
Ka familje që presin.
Ka net të gjata pune.
Ka përgjegjësi që mbahen në heshtje.
Ka vendime, peshën e të cilave mund ta kuptojë plotësisht vetëm ai që e ka mbajtur uniformën.
Prandaj, ky portret nuk është vetëm një renditje faktesh, datash, gradash dhe funksionesh. Është edhe një përshëndetje mes kolegësh të armës.

Një përshëndetje me respekt për një oficer që i shërbeu vendit me uniformë dhe që vazhdon t’i shërbejë atij me dije, mendim dhe përvojë. Prof. Dr. Kristaq Xharo, Kolonel në rezervë, mbetet një përfaqësues i denjë i atij brezi ushtarakësh dhe intelektualësh shqiptarë që i shërbyen vendit jo vetëm me uniformë, por edhe me mendim, dije dhe vizion.

Kontributi i tij dëshmon se profesioni ushtarak, në dimensionin e tij më të lartë, nuk është vetëm detyrë dhe karrierë, por edhe përgjegjësi intelektuale, mision qytetar dhe shërbim ndaj së ardhmes. Sepse shërbimi ndaj atdheut nuk përfundon ditën kur hiqet uniforma. Ai vazhdon në dijen që u përcillet brezave. Në përvojën që i lihet shoqërisë. Në mendimin që pasuron institucionet. Në studentët dhe kolegët që mbajnë dicka nga ajo që u ke dhënë. Në gjurmën që një njeri lë në kujtesën e institucionit dhe të vendit të tij.

I nderuar Profesor Kristaq Xharo,
Uniforma mund të vendoset një ditë mes kujtimeve, por nderi i shërbimit nuk del kurrë në rezervë.
Ai mbetet në emrin e mirë.
Në respektin e kolegëve.
Në kujtesën e studentëve.
Në dijen e përcjellë ndër breza.
Në institucionet ku ke shërbyer dhe ke lënë gjurmë.

Dhe, mbi të gjitha, mbetet në ndërgjegjen e qetë të atij që, kur kthen kokën pas mbi rrugën e përshkuar, mund të thotë me dinjitet: “I shërbeva vendit tim”. Për një ushtarak, nuk ka gradë më të lartë se nderi. Nuk ka medalje më të çmuar se respekti. Dhe nuk ka dekoratë më të madhe se kjo.

Nga sfida e parë te barazia e meritës, rrugëtimi i gruas shqiptare në Forcat e Armatosura



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të jesh grua është të mbartësh njëkohësisht forcën dhe ndjeshmërinë, përgjegjësinë dhe përkushtimin, familjen dhe profesionin. Të jesh **grua në uniformë** do të thotë të zgjedhësh një rrugë ku fjala detyrë merr një kuptim të veçantë dhe ku kontributi matet jo me gjininë, por me **aftësinë, profesionalizmin, karakterin dhe meritën**.

Historia e gruas në Forcat e Armatosura Shqiptare është një histori ndryshimi. Është historia e një pranie që dikur ishte e kufizuar, më pas u forcua, u konsolidua dhe sot është pjesë e pandashme e strukturave ushtarake, e arsimit të lartë ushtarak, e komandimit, e specialiteteve dhe e misioneve brenda dhe jashtë vendit.

Gruaja shqiptare në uniformë nuk është më një përjashtim. **Ajo është pjesë e Forcës.**

Dhe ky është një prej ndryshimeve më domethënëse që ka njohur institucioni ushtarak shqiptar ndër dekada.

Nga prania simbolike te përfaqësimi profesional Rrugëtimi i gruas në institucionet ushtarake shqiptare nuk ka qenë i lehtë dhe nuk është zhvilluar brenda natës.

Në historinë e Forcave të Armatosura, gratë kanë ardhur gradualisht në role dhe specialitete të ndryshme, duke fituar hapësirë përmes arsimit, përgatitjes profesionale dhe përkushtimit në detyrë.

Në fillimet e këtij rrugëtimi, ideja e gruas ushtarake përballej me shumë kufizime shoqërore e kulturore. Uniforma ishte parë për një kohë të gjatë si një hapësirë kryesisht mashkullore. Por koha ndryshoi dhe bashkë me të ndryshoi edhe vetë koncepti mbi rolin e gruas në mbrojtjen dhe sigurinë e vendit.

Gruaja hyri në uniformë dhe gradualisht dëshmoi se **profesioni ushtarak nuk është pronë e një gjinie**.

Ai kërkon karakter.

Kërkon disiplinë.

Kërkon dije.

Kërkon përgjegjësi.

Dhe këto nuk kanë gjini.

ARSIMIMI, ÇELËSI I NGJITJES PROFESIONALE

Një prej treguesve më të rëndësishëm të këtij ndryshimi është prania gjithnjë e më e madhe e grave në **institucionet akademike dhe arsimore ushtarake**.

Sot, vajza dhe gra shqiptare zgjedhin të ndërtojnë karrierën e tyre përmes arsimit ushtarak, trajnimeve profesionale, specializimeve dhe studimeve të avancuara.

Kjo është një pikë kthese.

Sepse karriera ushtarake nuk ndërtohet vetëm në terren. Ajo ndërtohet edhe në auditor, në laborator, në qendrat e trajnimit, në akademitë ushtarake dhe në institucionet e arsimit të lartë.

Gruaja që hyn në një institucion akademik ushtarak nuk kërkon një privilegj.

Ajo kërkon **mundësinë për të provuar veten**.

Dhe kur ajo përfundon studimet, merr gradën, përmbush detyrat dhe ngjitet në karrierë, ajo nuk përfaqëson vetëm veten. Ajo përfaqëson edhe brezin e vajzave që vijnë pas saj.

Çdo oficerë që arrin një pozicion drejtues i dërgon një mesazh të fuqishëm një vajze të re:

“Edhe ti mundesh.”

Uniforma nuk e zbeh gruan, e bën më të dukshme forcën e saj

Ka një keqkuptim të vjetër se për t’u bërë ushtarake, grua duhet të heqë dorë nga një pjesë e identitetit të saj.

E vërteta është ndryshe.

Gruaja nuk bëhet më pak grua sepse vesh uniformën.

Përkundrazi, në uniformë ajo sjell me vete gjithë atë që është: **dijen, kulturën, inteligjencën, vendosmërinë, ndjeshmërinë dhe aftësinë për të udhëhequr**.

Një oficerë mund të jetë njëkohësisht komandante dhe nënë. Mund të jetë pedagoge dhe ushtarake.

Mund të jetë pilote, mjeke, inxhinieri, specialiste komunikimi, juriste, specialiste logjistike, analiste apo pjesë e një strukture operacionale.

Kjo shumëllojshmëri rolesh është një prej pasurive të Forcave të Armatosura moderne. Sepse ushtria e shekullit XXI nuk kërkon vetëm forcë fizike.

Kërkon **mendje të afta, teknologji, dije, leadership, komunikim dhe profesionalizëm**.

Dhe në të gjitha këto fusha, grua shqiptare ka dëshmuar se ka vendin e saj.

GRUAJA NË KOMANDË

Ndoshta një nga ndryshimet më të mëdha është fakti se sot grua nuk shihet vetëm si pjesëtare e një strukture, por gjithnjë e më shumë si **drejtuese dhe vendimmarrëse**.

Nga detyra në detyrë, nga grada në gradë, gratë kanë



fituar hapësirë në nivelet e ndryshme të hierarkisë ushtarake. Ky është një proces që duhet parë jo thjesht si arritje e grave, por si **pasurim i vetë institucionit**. Një forcë e armatosur që shfrytëzon talentin, dijen dhe potencialin e të gjithë pjesëtarëve të saj është një forcë më e aftë.

Lidershipi nuk përcaktohet nga gjinia.

Përcaktohet nga aftësia për të marrë përgjegjësi, për të udhëhequr njerëzit, për të marrë vendime në kohë të vështira dhe për të mbajtur mbi vete peshën e detyrës.

Dhe gratë në uniformë po e dëshmojnë këtë çdo ditë.

NGA AUDITORI NË TERREN, NGA TERRENI NË MISION Rruga profesionale e gruas ushtarake është e gjatë dhe kërkon përgatitje të vazhdueshme. Ajo fillon në bankat e shkollës, vazhdon në institucionet e arsimit ushtarak, në repart, në stërvitje, në kurse specializimi dhe në misione.

Në çdo etapë kërkohet e njëjta gjë: **profesionalizëm**.

Sot gratë e Forcave të Armatosura marrin pjesë në trajnime, stërvitje dhe angazhime të ndryshme, përfshirë edhe ato në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe misioneve jashtë vendit.

Kjo përvojë nuk është vetëm një arritje individuale.

Ajo është edhe një tregues i ndërveprueshmërisë dhe standardeve të një force ushtarake që kërkon të jetë pjesë e strukturave dhe operacioneve moderne të sigurisë.

Gruaja shqiptare në uniformë është bërë kështu edhe **një përfaqësuese e Shqipërisë përtej kufijve**.

Në një sallë ndërkombëtare, në një trajnim të përbashkët apo në një mision, ajo nuk mbart vetëm uniformën e saj.

Ajo mbart flamurin.

NJË RRUgë QË NUK PËRFUNDON

Megjithatë, rrugëtimi drejt përfaqësimit të plotë nuk duhet parë si një proces i përfunduar. Çdo institucion duhet të vazhdojë të krijojë mundësi të barabarta për zhvillimin profesional, arsimimin, trajnimin dhe ngritjen në karrierë. Barazia nuk do të thotë që të gjithë duhet të jenë njësoj.

Do të thotë që **secili duhet të ketë mundësinë të dëshmojë çfarë është në gjendje të bëjë**.

Në Forcat e Armatosura kjo merr një kuptim edhe më të madh. Sepse ushtria është një institucion ku përgjegjësia është kolektive. Kur vendi ka nevojë, nuk pyet nëse je burrë apo grua. Pyet nëse je i përgatitur. Nëse je i gatshëm. Nëse mund ta përmbushësh misionin. Dhe pikërisht këtu qëndron thelbi i karrierës së gruas ushtarake.

GRATË QË HAPËN RRUgËN

Pas çdo arritjeje të sotme qëndrojnë gra që kanë hyrë në uniformë në një kohë kur rruga ishte më e vështirë. Ato janë brezi që u përball me skepticizmin, me paragjykimet dhe me pyetjen nëse grua mund të përballonte një profesion të tillë.

Përgjigjen nuk e dhanë me fjalë.

E dhanë me **punë**.

Me vite shërbimi. Me rezultate. Me grada. Me arsim. Me përgjegjësi. Me sakrifica.

Sot, një vajzë që hyn në Forcat e Armatosura nuk nis nga pika ku nisën ato. Ajo nis nga një rrugë që është hapur tashmë. Por kjo nuk ia zvogëlon meritën.

Përkundrazi.

Ajo ka një detyrë të re: **ta çojë më tej atë rrugë**.

GRUA, USHTARAKE DHE NËNË

Në këtë histori ka edhe një dimension që shpesh mbetet jashtë statistikave dhe raporteve. Gruaja ushtarake është edhe grua e familjes. Ajo njeh vështirësinë e detyrës, por njeh edhe përgjegjësinë ndaj fëmijëve, prindërve dhe familjes. Ka ditë kur uniforma kërkon të jesh larg shtëpisë. Ka stërvitje që zgjasin me orë. Ka misione që kërkojnë sakrificë. Ka momente kur detyra vjen e para.

Por pikërisht këtu qëndron një prej dimensioneve më njerëzore të gruas në uniformë: **ajo e di peshën e përgjegjësisë dhe megjithatë vazhdon**.

Kjo nuk është dobësi.

Është forcë.

NJË MESAZH PËR VAJZAT E REJA

Sot, kur një vajzë e re mendon për të ardhmen e saj, ajo ka më shumë zgjedhje se dikur.

Nëse zgjedh Forcat e Armatosura, ajo duhet ta dijë se rruga nuk është e lehtë. Por është një rrugë me dinjitet. Është një profesion ku mund të studiosh, të specializohesh, të udhëheqësh, të shërbesh dhe të përfaqësosh vendin. Nuk është e nevojshme të kërkoesh një rrugë të veçantë sepse je grua.

Mjafton të kërkoesh rrugën e meritës.

Dhe ta ndjekësh me këmbëngulje.

TË JESH GRUA...

Të jesh grua në Forcat e Armatosura nuk do të thotë të kërkoesh një vend që të falet.

Do të thotë të fitosh vendin tënd me dije, punë dhe përkushtim.

Do të thotë të hysh në auditor dhe të studiosh.

Të hysh në repart dhe të stërvitesh.

Të marrësh përgjegjësi.

Të komandos kur të kërkoet.

Të mësosh nga të tjerët.

Të udhëheqësh ata që vijnë pas teje.

Dhe mbi të gjitha, të jesh e gatshme të shërbesh.

Të jesh grua në uniformë është të dëshmosh se forca nuk ka një fytyrë të vetme.

Ka shumë forma.

Njëra prej tyre është ajo e gruas që ecën me vendosmëri në rresht, që mban uniformën me dinjitet, që studion për të qenë më e aftë, që merr përgjegjësi dhe që nuk kërkon asgjë më shumë se mundësinë për të dhënë më të mirën e saj.

Nga brezat e parë që hapën rrugën, te vajzat dhe gratë që sot janë në auditorë, në reparte, në qendra trajnimi, në poste drejtuese dhe në misione, rrugëtimi vazhdon.

Ajo që dikur dukej si përjashtim, sot është pjesë e natyrshme e Forcave të Armatosura.

Dhe kjo është ndoshta fitorja më e madhe.

Jo sepse grua ka hyrë në një hapësirë që dikur i përkiste burrit.

Por sepse **institucioni ka kuptuar se forca e tij rritet kur talenti, dija dhe përkushtimi i çdo individi gjejnë vendin që meritojnë**.

Gruaja në uniformë nuk është vetëm pjesë e së ardhmes së Forcave të Armatosura. Ajo është pjesë e së tashmes së tyre.

Të jesh grua... të jesh ushtarake... të jesh profesioniste... dhe mbi të gjitha, të shërbesh me dinjitet për Shqipërinë.

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shqipëria e vitit 1882 në një tablo të Rudolf Otto von Ottenfeld, një copëz jete, tradite dhe ndjenje e ruajtur në penel

Fotografitë na tregojnë të kaluarën, ato janë dokumente që na e dëshmojnë atë. Por ka edhe vepra arti që bëjnë diçka më shumë: **na lejojnë ta shohim të kaluarën me sytë e një njeriu që e ka përjetuar atë në kohën e vet.**

Një prej këtyre dëshmime të rralla është tabloja që sjellim në këtë faqe, atribuuar **Shqipërisë, e vitit 1882**, nga piktori austriak **Rudolf Otto von Ottenfeld**. Në qendër të saj është një skenë e thjeshtë, e përditshme dhe njëkohësisht jashtëzakonisht njerëzore: një vajzë shqiptare pranë një kroi fshati dhe një kalorës i armatosur që duket sikur ka ndaluar për një çast në rrugën e tij. Mes tyre nuk ka fjalë. Nuk kemi nevojë për to.

Një shikim, një ndalesë, një gjest i dorës dhe një heshtje që duket sikur fsheh një histori dashurie.

Ndoshta pikërisht aty qëndron bukuria e kësaj tabloje. Ajo nuk paraqet një betejë, një kuvend burrash apo një ngjarje të madhe historike. Paraqet një çast të zakonshëm të jetës. Por pikërisht përmes këtij çasti të vogël, piktori na ka lënë një dritare të hapur drejt Shqipërisë së shekullit XIX.

Një Shqipëri e parë me sytë e një artisti ushtarak
Rudolf Otto von Ottenfeld lindi më 21 korrik 1856 në Verona dhe vdiq në Pragë më 1913. Ai u formua artistikisht në Akademinë e Arteve të Bukura në Vjenë, ku studioi ndër të tjerë me Karl Wurzinger dhe Leopold Carl Müller. Por Ottenfeld nuk ishte një artist që e shihte botën vetëm nga studioja. Ai ndërmori udhëtime studimore në hapësirat e Ballkanit dhe më gjerë. Burime biografike të kohës përmendin udhëtime në Dalmaci, Bosnjë, Hercegovinë, Kostandinopojë, Azinë e Vogël dhe Kaukaz. Kjo përvojë udhëtimi ishte e rëndësishme për mënyrën se si ai e ndërtoi botën e tij artistike. Në veprat e tij, njerëzit, veshjet, armët, kuajt, arkitektura dhe peizazhet nuk janë thjesht elemente dekorative. Ato janë përpjekje për të fiksuar një realitet që po ndryshonte. Në këtë kuptim, edhe tabloja e vitit 1882 që po sjell sot për lexuesin mund të lexohet si **një dokument pamor i Shqipërisë së asaj kohe**. Një Shqipëri ende nën Perandorinë Osmane, me rrugë të vështira, fshatra të vegjël, kroje që ishin pjesë e jetës së përditshme dhe një shoqëri ku tradita, nderi, familja dhe zakonet përcaktonin fort mënyrën e jetesës.

Kroi, vendi ku kryqëzoheshin rrugët dhe fatet
Në fshatin shqiptar të dikurshëm, kroi nuk ishte thjesht një burim uji. Ai ishte **vend takimi**. Aty shkonin vajzat për të mbushur ujë. Aty ndaleshin udhëtarët. Aty kalonin banorët e fshatit. Aty shkëmbeheshin fjalë, lajme dhe vështrime. Në një kohë kur jeta nuk kishte telefon, rrjete sociale, mesazhe apo mënyrat e sotme të komunikimit, njerëzit kishin vendet e tyre të takimit. Kroi ishte një prej tyre. Prandaj, pamja e kësaj vajze pranë burimit të ujit mund të na duket sot e zakonshme, por për shoqërinë e asaj kohe ajo përfaqëson një pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme. Vajza mban enën e ujit. Veshja e saj është e gjatë dhe e mbuluar, ndërsa në bel dallohen pjesë të kostumit tradicional. Përballë saj ndodhet kalorësi, me veshjen karakteristike dhe armën e gjatë në dorë. Ai ka ndaluar. Ajo ka ngritur sytë. Dhe në këtë çast të vogël lind pyetja që tabloja nuk i përgjigjet:

A u takuan për herë të parë? A njiheshin më parë? Ishte një përshëndetje e zakonshme apo një takim i fshehtë?

Arti ka këtë fuqi: të na japë një pamje dhe të na lërë ne të ndërtojmë historinë.

Një dashuri e heshtur pranë ujit
“Kur dashuria lind pranë kroit të fshatit”

Sepse dashuria e dikurshme nuk kishte nevojë për shumë fjalë. Një shikim mund të zgjaste më shumë se një bisedë. Një ndalesë e shkurtër mund të mbetej gjatë në kujtesë. Një takim pranë kroit mund të ishte fillimi i një historie që askush tjetër nuk e dinte. Dhe pikërisht kjo e bën skenën kaq njerëzore. Në çdo epokë, pavarësisht mënyrës së jetesës, njerëzit kanë dashuruar, kanë ëndërruar, kanë pritur dhe janë ndarë. Ndryshojnë rrobat, rrugët, mënyrat e komunikimit, por **ndjenja njerëzore mbetet e njëjtë**. Vajza e tablosë mund të jetë një vajzë e zakonshme shqiptare e vitit 1882. Por përmes penelit të Ottenfeldit ajo është bërë një figurë që jeton edhe sot. Ajo nuk ka emër. Nuk dimë nga cili fshat është. Nuk dimë nëse u martua, nëse priti dikë apo nëse ajo skenë ishte thjesht një çast i zakonshëm i ditës. Por e dimë se dikush e pa. Dhe vendosi ta ruajë atë çast përgjithmonë.

Kostumi që flet për një kohë
Një nga vlerat më të rëndësishme të veprës është edhe mënyra se si piktori ka fiksuar **veshjen tradicionale shqiptare**. Për studiuesin e historisë dhe etnografisë, një tablo e tillë nuk është vetëm art. Është edhe një burim vizual. Ottenfeld njihet për interesimin e tij të veçantë ndaj figurës njerëzore, kostumeve, armëve dhe skenave ushtarake. Veprat dhe ilustrimet e tij lidhen ngushtë me interesimin për historinë ushtarake dhe botën ballkanike e orientale. Në pikturat e tij me shqiptarë, sipas vëzhgimeve të botuara mbi krijimtarinë e tij, dallohen përpjekjet për të përcjellë me hollësi kostumet, armët dhe tiparet e jetës së kohës. Në këtë tablo, kostumi i vajzës nuk është një element i rastësishëm. Ai na tregon për mënyrën e veshjes, për modestinë dhe normat shoqërore të kohës, por edhe për pasurinë e kulturës materiale shqiptare. Po kështu, figura e kalorësit, arma, kali dhe mënyra e qëndrimit të tij sjellin në pamje një botë ku **kalorësia, udhëtimi dhe mbajtja e armës ishin pjesë e realitetit të përditshëm**.

Kështu, një skenë që në pamje të parë duket romantike, bëhet edhe një dokument i historisë sociale.

Shqipëria e vogël që hyri në artin europian
Në shekullin XIX, Ballkani dhe Perandoria Osmane tërhoqën vëmendjen e shumë udhëtarëve, studiuesve, shkrimtarëve dhe artistëve europianë. Shqipëria, me peizazhin e saj malor, kostumet e veçanta, traditat, figurat e armatosura dhe jetën e saj ende pak të njohur për publikun europian, përbënte një botë që artistët dëshironin ta njihnin dhe ta dokumentonin. Ottenfeld ishte pjesë e këtij interesi artistik. Por sot, kur e shohim këtë

KUR DASHURIA LINDTE PRANË KROIT



tablo nga këndvështrimi shqiptar, rëndësia e saj merr një tjetër dimension. Ne nuk shohim vetëm “Orientin” e imagjinuar nga një artist europian.

Shohim një copëz të Shqipërisë sonë.
Shohim një fshat.
Shohim një krua.
Shohim një vajzë.
Shohim një burrë mbi kalë.
Shohim veshjet e një kohe.
Shohim një mënyrë jetese që sot nuk ekziston më në atë formë.

Dhe mbi të gjitha, shohim njerëz.
Një tablo që na mëson të shohim historinë ndryshe
Historia shpesh na vjen përmes luftërave, traktateve, mbretërve, kuvendeve dhe datave. Por një shoqëri nuk jeton vetëm në këto ngjarje. Historia jeton edhe te **uji që sillte vajza nga kroi, te rruga ku kalonte kalorësi, te oborri i shtëpisë, te kostumi i veshur përditë, te kali që përdorej për udhëtim, te mënyra se si njerëzit shikonin njëri-tjetrin**. Kjo është historia sociale. Sepse pas uniformës, armës dhe historisë ushtarake është gjithmonë **njeriu**.

Ottenfeld, si piktor me formim dhe interesim të fortë ushtarak, na ka lënë jo vetëm skena që lidhen me luftën dhe ushtarin, por edhe pamje ku njeriu shfaqet në marrëdhënie me jetën e përditshme. Biografitë e tij e përshkruajnë si piktor të historisë ushtarake dhe pedagog, ndërsa vepra e tij lidhet edhe me dokumentimin artistik të uniformave dhe historisë së ushtrisë.

Mes të shkuarës dhe së tashmes
Sa shumë ka ndryshuar Shqipëria nga viti 1882 deri sot! Kroi i fshatit është zëvendësuar në shumë vende nga ujësjellësi. Rrugët janë mbushur me makina. Kuajt nuk janë më mjeti kryesor i udhëtimit. Veshjet tradicionale nuk janë më veshje të përditshme. Komunikimi nuk kërkon më takime të gjata pranë krojeve. Sot mjafton një telefon për të folur me dikë në anën tjetër të botës. Por ka diçka që nuk ka ndryshuar.
Njeriu vazhdon të kërkojë dashurinë. Vazhdon të presë. Vazhdon të ëndërrojë. Vazhdon të emocionohet nga një shikim. Në këtë kuptim, tabloja e Ottenfeldit nuk është vetëm një pamje e vitit 1882. Ajo është një pasqyrë ku mund të shohim edhe veten. Ndoshta kjo është arsyeja pse, më shumë se një shekull pas krijimit të saj, ajo vazhdon të na tërheqë.
Një histori që nuk e dimë, por që mund ta imagjinojmë

Le ta imagjinojmë për një çast atë mëngjes apo pasdite të largët të vitit 1882. Fshati është i qetë. Diku dëgjohet uji. Vajza vjen me enën e saj. Rruga është e pluhurosur. Nga larg shfaqet një kalorës. Kali ndalon. Ai i drejtohet vajzës. Ajo ngre kokën. Ndoshta flasin për pak çaste. Ndoshta nuk thonë asgjë. Pastaj kalorësi vazhdon rrugën. Vajza mbetet pranë kroit. Dhe jeta vazhdon. Një moment i tillë, që për njerëzit e asaj kohe mund të ketë zgjatur vetëm disa sekonda, u bë objekt i një vepre arti. **Kjo është mrekullia e pikturës.** Ajo e ndal kohën.

Nga një çast i vogël te kujtesa kombëtare
Sot, kur shohim këtë vepër, duhet ta vlerësojmë jo vetëm për bukurinë artistike, por edhe për atë që na përcjell. Ajo na ndihmon të kuptojmë se si dukej një pjesë e jetës shqiptare në shekullin XIX. Na kujton rëndësinë e kostumeve tradicionale, të krojeve, të arkitekturës popullore, të kalit si mjet udhëtimi dhe të marrëdhënieve njerëzore në një shoqëri krejt tjetër nga e sotmja. Dhe mbi të gjitha, na tregon se **Shqipëria ka qenë gjithmonë një vend me njerëz, histori dhe ndjenja që kanë ditur të tërheqin vëmendjen e artistëve të huaj**.

Rudolf Otto von Ottenfeld ishte një prej tyre.
Një artist që e pa Shqipërinë me sytë e shekullit XIX dhe e fiksoi në tela.

Sot, ne e shohim veprën e tij me sytë e shekullit XXI.
Mes këtyre dy kohëve qëndron një tablo.

Një vajzë.
Një kalorës.
Një krua.

Dhe një histori dashurie që mund të ketë ndodhur ose mund të jetë vetëm ajo që imagjinojmë. Por ndoshta nuk ka shumë rëndësi nëse ata dy personazhe kanë qenë vërtet të dashuruar.

Rëndësi ka se piktori arriti të kapte një çast aq njerëzor, saqë edhe sot, pas më shumë se 140 vitesh, ne vazhdojmë t’i shohim dhe të pyesim veten: çfarë u tha atë ditë pranë kroit?

Kjo është fuqia e artit. Dhe kjo është edhe fuqia e kujtesës.
Një Shqipëri e vitit 1882 na vjen sot përmes një peneli austriak, për të na kujtuar se historia nuk jeton vetëm në arkiva. Ajo jeton edhe në një shikim, në një veshje, në një krua fshati dhe në një histori dashurie të mbetur përgjithmonë pa fjalë.



KONTRIBUT I ÇMUAR

Gazeta “Ushtria” sjell për lexuesit këtë material të Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemit dhe Shefki Velajt, kushtuar 82-vjetorit të Betejës së Dukajt dhe lapidarit të ri të dëshmorëve. Ky kontribut i çmuar i bashkohet përpjekjeve për ruajtjen dhe përcjelljen e kujtesës historike e ushtarake te brezat e rinj.

Një homazh për të rënë dhe një amanet për kujtesën historike

Ka vende që historia i ka shndërruar në simbole. Vende ku toka, njerëzit dhe kujtesa janë bërë pjesë e një rrëfimi që nuk shuhet me kalimin e viteve. I tillë është **Dukaj i Labërisë**, fshati që ruan në kujtesën e tij gjurmët e trimërisë, qëndresës dhe sakrificës së bijve të tij. Ato bëhen pjesë e kujtesës së një kombi sepse në tokën e tyre janë shkruar me sakrificë dhe gjak faqe të rëndësishme të historisë. **Ka vende që historia i ka shndërruar në simbole.** Vende ku toka, njerëzit dhe kujtesa janë bërë pjesë e një rrëfimi që nuk shuhet me kalimin e viteve. I tillë është **Dukaj i Labërisë**, fshati që ruan në kujtesën e tij gjurmët e trimërisë, qëndresës dhe sakrificës së bijve të tij.

Pas 82 vitesh, kujtimi i kësaj beteje rikthehet në vëmendjen e brezave përmes një akti të bukur dhe domethënës: **ringritjes së lapidarit të dëshmorëve të Dukajt**. Nisma e bijve të fshatit, me mbështetjen e **Shoqatës Kulturore Atdhetare “Dukaj”**, është më shumë se një vepër përkujtimore. Është një shenjë respekti për historinë, një dëshmi e dashurisë për vendlindjen dhe, mbi të gjitha, një amanet që emrat e atyre që ranë për lirinë të mos zbehen nga koha. Lapidari i ri, me emrat e dëshmorëve të lartësuar në gur, bëhet një pikë referimi për kujtesën historike të Dukajt dhe të gjithë Labërisë. **Guri i monumentit nuk është i heshtur:** ai “flet” për një brez që në ditët e vështira të luftës zgjodhi të përballej me rrezikun dhe të sakrifikonte jetën.

Më 25 korrik 1944, në **Shkëmbin e Prerë dhe në pozicionet përreth Dukajt**, u zhvillua një betejë e ashpër ndërmjet forcave të Brigadës së VI Sulmuese dhe forcave gjermane e bashkëpunëtorëve të tyre. Luftimet qenë të egra dhe, në disa momente, arritën deri në përleshje trup më trup.

Në atë përballje ranë **11 dëshmorë**.

Mes tyre spikasin emra që historia e luftës i ka ruajtur me respekt. **Apostol Leonidha Çuni nga Piqerasi**, i armatosur me bomba, u drejtua drejt pozicioneve të fortifikuara të armikut. Me dy bomba goditi pozicionin e mitralozit gjerman, duke asgjësuar dy mitraljerë. Më pas u gjet i vrarë mbi armën e tij. Një akt i tillë, në kushtet e një beteje të ashpër, dëshmon vendosmërinë dhe sakrificën e luftëtarëve të asaj kohe.

Një tjetër figurë e rëndësishme e betejës ishte **Mitro Xhani**, i njohur edhe me pseudonimin “Balena”, komandant i luftimeve dhe drejtues në vijën e parë të përballjes. Ai udhëhoqi sulmin drejt pozicioneve të armikut dhe ra në betejë, duke mbetur në kujtesën e brezave si **Hero dhe Dëshmor i Atdheut**.

Historia e Dukajt nuk duhet parë vetëm si një episod i largët i vitit 1944. Ajo është pjesë e kujtesës së një krahine që gjatë luftës përjetoi sakrifica të mëdha. Prandaj, ringritja e lapidarit merr një kuptim të veçantë: **brezi i sotëm i vendos emrat e të rënëve përsëri në vendin e tyre të nderit**.

Kjo është edhe vlera më e madhe e një monumenti përkujtimor. Ai nuk i përket vetëm së kaluarës. I flet së tashmes dhe së ardhmes. U thotë brezave se liria nuk është një fjalë abstrakte, por një vlerë që është mbrojtur dhe fituar edhe me sakrifica njerëzore. Emrat e gdhendur në lapidar janë dëshmi se pas historisë së madhe qëndrojnë njerëz konkretë, me familje, ëndrra dhe jetë të ndërprera në një moshë të re.

Në këtë kuptim, **lapidari i ri i Dukajt është një urë mes brezave**. Është ura që lidh kujtesën e atyre që ranë me brezat që sot jetojnë në liri. Është një ftesë për të mos harruar dhe një detyrim moral për ta njohur historinë.

Nisma e bijve të Dukajt dhe e Shoqatës Kulturore Atdhetare



“Dukaj” meriton vlerësim pikërisht sepse tregon se kujtesa historike nuk ruhet vetëm në libra e arkiva. Ajo ruhet edhe në vendet ku kanë ndodhur ngjarjet, në monumentet e ngritura për dëshmorët dhe në ndërgjegjen e komunitetit.

82 vjet pas betejës së përgjakshme të 25 korrikut 1944, emrat e dëshmorëve të Dukajt rikthehen të gdhendur në një lapidar të ri. Ata vazhdojnë të jenë pjesë e historisë së fshatit,

të Tepelenës, të Labërisë dhe të Shqipërisë.

Prandaj, ky lapidar nuk duhet parë thjesht si një monument guri. **Ai është një amanet.**

Një amanet që na thotë se koha mund të kalojë, brezat mund të ndërrohen, por kujtimi për ata që dhanë jetën për një ideal të madh nuk duhet të shuhet.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Dukaj, fshati i historisë, i trevës labe, trimërisë dhe qëndresës, ruan në kujtesën e tij një nga betejat më të përgjakshme të vitit 1944 në trevën e Tepelenës dhe të Labërisë. Më 25 korrik 1944, në Shkëmbin e Prerë dhe në pozicionet përreth Dukajt, u zhvillua një përballje e ashpër e forcave të Brigadës së VI Sulmuese me forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Në atë betejë ranë 11 dëshmorë. Pas 82 vitesh, kujtimi i tyre vjen para nesh në një formë të re dhe më dinjitoze. Bijtë e Dukajt, përmes nismës së tyre dhe me mbështetjen e Shoqatës Kulturore Atdhetare “Dukaj”, kanë ringritur lapidarin e dëshmorëve.

Ky monument është një shprehje e drejtpërdrejtë e nderimit, respektit dhe mirënjohjes për ata që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë. Lapidari i ri nuk është vetëm një vepër e ngritur në hapësirën e fshatit. Ai është një dëshmi e gjallë se kujtesa nuk shuhet. Është një amanet që emrat e dëshmorëve të ruhen dhe t’u përcillen brezave.

Beteja e 25 korrikut 1944

Në verën e vitit 1944, forcat gjermane kishin vendosur pozicione të rëndësishme në Dukaj, në funksion të kontrollit të rrugës Tepelenë-Vlorë. Në zonë vepronin forca të ndryshme të armatosura, ndërsa terrori dhe dhuna ndaj popullsisë e kishin rënduar gjendjen në fshatrat e Tepelenës dhe të Kurveleshit.

Pas marrjes së informacionit për veprimet e forcave armike në Dukaj dhe Salari, shtabi i Brigadës së VI Sulmuese përgatiti planin e sulmit. Në mbrëmjen e 24 korrikut 1944, në Damës, luftëtarët e Batalionit të Dytë u vunë në lëvizje. Të nesërmen, më 25 korrik, forcat partizane, në bashkëpunim me forcat territoriale, rrethuan pozicionet armike.

Luftimet u zhvilluan me intensitet të madh. Përleshjet arritën deri në luftime trup më trup dhe një nga pikat më të forta të përballjes ishte Shkëmbi i Prerë. Në këtë betejë u dalluan për trimëri disa luftëtarë që më pas do të mbeteshin në kujtesë si dëshmorë të Atdheut. Apostol Leonidha Çuni nga Piqerasi, i armatosur me bomba, u drejtua drejt pozicioneve gjermane në kodrën shkëmbore. Me dy bomba ai goditi pozicionin e mitralozit gjerman dhe asgjësoi dy mitraljerë. Më pas, forcat partizane e gjetën të vranë mbi armën e tij.

Një tjetër figurë qendrore e betejës ishte Mitro Xhani, komandant i luftimeve, i njohur edhe me pseudonimin “Balena”. Ai luftoi në vijën e parë dhe udhëhoqi sulmin drejt pozicioneve armike. Mitro Xhani ra në betejë, duke mbetur Hero dhe Dëshmor. Sakrifika e tyre bëri që beteja të përfundonte me marrjen e pozicioneve të fortifikuara të armikut.

Emrat që u shkruan me gjak. Beteja e Dukajt la pas një bilanc të rëndë. Në fushën e nderit ranë 11 dëshmorë, bij të viseve të ndryshme të Shqipërisë, të cilët u bashkuan në Dukaj në të njëjtin ideal të lirisë. Ata ishin: Mitro Xhani, nga Piqerasi, drejtues dhe luftëtar i Brigadës së VI Sulmuese, më vonë Hero i Popullit dhe Dëshmor i Atdheut. Apostol Leonidha Çuni, nga Piqerasi, i cili ra gjatë sulmit mbi pozicionet e fortifikuara në Shkëmbin e Prerë. Avdyl Demiri, nga Kallarati i Vlorës, zv/komandant i kompanisë së dytë. Barxho Asqeri Abazaj, nga Progonati, komandant skuadre, i cili ra në përballjen e zhvilluar në prag të sulmit mbi Dukajn. Mitko Velço dhe Jorgo Jovani, nga Kudhësi i Himarës; Jaho Brahja dhe Koço Koçollari, nga Gjirokastra; Kutbi Çelo Gjeçi, nga Fushëbardha e Gjirokastrës, i lindur më 25 shkurt 1924 dhe i rënë më 25 korrik 1944 në Dukaj. Ai u shpall “Dëshmor

Ky monument është një shprehje e drejtpërdrejtë e nderimit, respektit dhe mirënjohjes për ata që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë. Lapidari i ri nuk është vetëm një vepër e ngritur në hapësirën e fshatit. Ai është një dëshmi e gjallë se kujtesa nuk shuhet. Është një amanet që emrat e dëshmorëve të ruhen dhe t’u përcillen brezave.

i Atdheut” me vendimin nr. 65, datë 2 tetor 1971, të ish-Komitetit Ekzekutiv të Rrethit Gjirokastrë. Ismail Xhemali Çacaj, nga Toskmartallozi; Rushan Murat Goxhaj, nga Nivica e Kurveleshit, zv/komandant i kompanisë së katërt.

Këta emra përfaqësojnë jo vetëm një fshat apo një krahinë. Ata janë pjesë e historisë së përbashkët të Shqipërisë. Bij nga Piqerasi, Kallarati, Progonati, Kudhësi, Fushëbardha, Nivica, Gjirokastra e vise të tjera u bashkuan në Dukaj dhe aty lanë jetën. Kjo është arsyeja pse lapidari i ri merr një rëndësi përtej kufijve të Dukajt. Ai është një monument i kujtesës së Labërisë dhe i mirënjohjes shqiptare.

82 vite më pas, kujtesa ringrihet. Në mesditën e 25 korrikut 1944, pas përfundimit të luftimeve, në ambientet e shkollës ku kishin qenë vendosur pozicionet gjermane u zhvillua ceremonia e fitores dhe varrimi me nderim i 11 dëshmorëve. Që prej asaj dite, emrat e tyre janë ruajtur në kujtesën e Dukajt dhe të krahinës. Për ta është folur, është shkruar dhe janë përcjellë dëshmi brez pas brezi. Sot, 82 vite më vonë, bijtë e Dukajt kanë zgjedhur ta shprehin këtë kujtesë përmes një vepre konkrete.

Ringritja e lapidarit është një akt qytetarie dhe përgjegjësie ndaj historisë. Merita për këtë nismë u takon bijve të Dukajt që u bashkuan për ta bërë monumentin më të denjë për historinë e fshatit dhe për sakrificën e dëshmorëve. Midis tyre janë përmendur Fatmir Kaba, Hamiti, Gazi, Astriti, Arbeni, Luani, Myrdari dhe shumë të tjerë. Kjo frymë është shfaqur edhe në nisma të tjera për përmirësimin e jetës dhe pamjes së fshatit, përfshirë bustin e heroit Memo Nexhipi, rregullimin dhe gjelbërimin e qendrës, çezmat, ambientet pritëse dhe bujtinat. Por lapidari i dëshmorëve mbetet simboli më i fuqishëm i kësaj pune, sepse lidhet drejtpërdrejt me kujtesën e atyre që nuk u kthyen më në shtëpitë e tyre.

Heronjtë dhe dëshmorët e fshatit Dukaj: Memo Nexhip Bejko (1926, Dukaj – 2.8.1949, Vidohovë), ra në moshën 23-vjeçare, shpallur Hero i Popullit dhe Dëshmor i Atdheut, me vendimin nr.157, datë 10.12.1983. Titulli Hero i Popullit iu akordua me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor. Eshtrat prehen në Varrezat e Dëshmorëve në Tepelenë; Hysen Dino Hajdinaj (1882, Dukaj – 1914, Labovë), ra në luftime kundër andartëve grekë, në moshën 32-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut, me vendimin nr. 142, datë 26.11.1984 (Libri zyrtar Dëshmorët e Atdheut, f. 79.); Turabi Çausht Halilaj (1887 – 1920), ra në Luftën e Vlorës, në moshën 33-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendim nr. 28, datë 15.5.1970 (Libri zyrtar Dëshmorët e Atdheut, f. 79.); Barjam Selfo Bejko (1910, Dukaj – 1944, Vranisht), ra në moshën 34-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Braho Qazim Brahaj (1928, Dukaj – 1944, Krujë), ra në moshën 16-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut, me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Dine Osmën Bejko (1922, Dukaj – 1944, Tepelenë), ra në moshën 22-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 6.3.1972; Doko Dino Muçaj (1908, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën

36-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 153, datë 1.2.1983; Hekuran Metush Bejaj (1923, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 19-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Hakik Barjam Varfaj (1920, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 24-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheu me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Hyso Qerim Hysaj (1919, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 25-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Hamit Barjam Berxhaj (1919, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 25-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Hysen Osmën Hysomataj (1896, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 48-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 58, datë 1.6.1983; Ismail Osmën Bejko (1912, Dukaj – 1944, Tepelenë), ra në moshën 32-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Kaso Isa Islami (1908, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 36-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Kamber Osmën Hysomataj (1920, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 24-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Mehmet Ali Shehu (1927, Dukaj – 1944, Vlorë), ra në moshën 17-vjeçare, Shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Muharrem Çausht Halilaj (1921, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 23-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Muhamet Ramo Jeraj (1900, Dukaj – 1944, Mali i Këndrevicës), ra në moshën 44-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 149, datë 27.12.1984; Muho Ramo Haxhaj (1926, Dukaj – 1944, Leskovik), ra në moshën 18-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Riza Osmën Bejko (1900, Dukaj – 1944, Dibër), ra në moshën 44-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Seit Hamit Kabaj (1929, Dukaj – 1944, Gjirokastrë), u ekzekutua me djegie në moshën 15-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971. Eshtrat e tij nuk u gjetën, pasi u dogj nga nazistët gjermanë. Për këtë arsye meriton një varr simbolik; Selfo Zyflo Prastaj (1918, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 26-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Teme Myslym Muçaj (1903, Dukaj – 1944, Dukaj), ra në moshën 41-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 66, datë 3.10.1992; Dino Myrteza Hajdinaj (1928, Dukaj – 1944, Krujë), ra në moshën 16-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 44, datë 3.8.1971; Dervish Dule Prasta (1918, Dukaj – 1943, Tepelenë), ra në moshën 25-vjeçare, shpallur Dëshmor i Atdheut me vendimin nr. 510, datë 20.12.2011.

Një amanet për brezat. Monumentet kanë vlerë kur nuk mbeten vetëm gurë dhe mermer, por vlera e tyre qëndron te kujtesa që përcjellin. Lapidari i ri i Dukajt i kujton çdo vizitori se liria e vendit ka pasur një çmim dhe se pas historisë së madhe kombëtare qëndrojnë emra njerëzish, familje dhe jetë të ndërprera në moshë të re. Për Labërinë, kjo kujtesë ka një domethënie të veçantë. Në historinë e saj janë të shumtë bijtë që u ngritën në mbrojtje të vendit dhe që e paguan me jetën e tyre idealin e lirisë.

Prandaj, kur përkulemi sot para lapidarit të ri të Dukajt, nderojmë jo vetëm 11 dëshmorët e rënë, më 25 korrik 1944. Ne nderojmë të gjithë bijtë e Labërisë dhe të Shqipërisë që dhanë jetën për Atdheun.

Le të mbetet ky lapidar një vend kujtese, një dëshmi e historisë dhe një amanet për brezat. Për heronjtë dhe dëshmorët flet historia, për betejën e Dukajt flet historia e dokumentuar në arkiva, në këngë dhe gojëdhënë e popullit, ndërkohë që dhjetëra shkrime tregojnë studimet e dëshmitarë të kohës, mes tyre Resul Bedo, Sevo Tarifa, Selfo Allka, Avdul Kaba, Ferit Lila dhe Sami Hadëri dhe shumë të tjerë, ku botime si “Lufta kundër qendrave të fortifikuara të armikut në Salari dhe Dukaj”, botuar nga Muzeu i Gjirokastrës në vitin 1971, dhe shumë të tjera flasin përmes fakteve e ngjarjeve reale të Luftës Nacionalçlirimtare në Shqipëri gjatë viteve 1939-1944.

Nderim në përjetësi dëshmorëve të fshatit Dukaj dhe gjithë dëshmorëve të Shqipërisë! Mirënjohje për bijtë e Labërisë që dhanë jetën për lirinë e Shqipërisë. Emrat e tyre mbeten të shkruar në altarin e nderit të historisë së Atdheut dhe kombit shqiptar.

Petro Nini Luarasi - Kur letra bëhej mësim për gjuhën dhe atdheun

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Një dorëshkrim i vitit 1907 dhe mesazhi i tij për brezat

Në historinë e Rilindjes Kombëtare shqiptare pati figura që nuk u mjaftuan vetëm me fjalën e bukur për Shqipërinë, por punuan që ajo fjalë të bëhej **dije, arsim, gjuhë dhe ndërgjegje kombëtare**. Një prej tyre ishte **Petro Nini Luarasi**, mësuesi, patrioti dhe veprimtari i palodhur i shkollës shqipe.

Në vitin 1907, kur ndodhej në Franklin, Massachusetts, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Petro Nini Luarasi përgatiti një dorëshkrim me një synim sa praktik, aq edhe atdhetar: t'u mësonte fëmijëve shqiptarë **si të shkruanin letra në gjuhën shqipe**. Dorëshkrimi mbeti pa u botuar në atë kohë, por vetë përmbajtja e tij dëshmon qartë përpjekjet e rilindësve për ta kthyer gjuhën shqipe në mjet të përditshëm komunikimi, edukimi dhe bashkimi kombëtar.


“Letrare a letërschkresë quhetë libra që na mëson udhënë a mënyrënë me të cilënë mundimë të shkruajmë letrë”, shkruan Petro Nini Luarasi në hyrje të dorëshkrimit. Pas kësaj fjalie të thjeshtë qëndron një ide e madhe: **shqiptari duhej të mësonte jo vetëm të fliste shqip, por edhe të shkruante shqip**.

Në një kohë kur gjuha shqipe përballej me pengesa të shumta dhe shkollimi në gjuhën amtare ishte një përpjekje e vështirë, një libër që mësonte mënyrën e shkrimit të letrave kishte një rëndësi shumë më të madhe se sa duket në pamje të parë. Ai synonte të krijonte një komunikim të shkruar mes shqiptarëve, të forconte përdorimin e shqipes dhe të edukonte brezin e ri me dashurinë për gjuhën amtare.

Një letër, një lidhje mes shqiptarëve

Për Petro Nini Luarasin, letra nuk ishte thjesht një mjet për të përcjellë një lajm nga një njeri te tjetri. Në përkufizimin e tij, letra ishte **shprehje e ndjenjave, e gëzimeve dhe e mendimeve tona**, që ia bëjmë të njohura një personi tjetër pa qenë pranë tij.

Në këtë kuptim, letra ishte edhe një formë lidhjeje



njerëzore e kombëtare. Ajo bashkonte njerëz të ndarë nga largësia, por që kishin të përbashkët gjuhën, kujtesën dhe përkatesinë.

Kjo ide merr një domethënie të veçantë kur kujtojmë se dorëshkrimi u përgatit në **Franklin të Massachusetts-it**, larg Shqipërisë. Vetë vendi ku u shkrua është një dëshmi e shtrirjes së veprimtarisë së shqiptarëve jashtë atdheut. Mërgimtarët shqiptarë nuk ishin shkëputur nga çështja kombëtare; përkundrazi, në shumë raste, ata u bënë mbështetës të rëndësishëm të arsimit dhe të gjuhës shqipe.

Petro Nini Luarasi e kuptonte se **gjuha ishte një nga shtyllat kryesore të identitetit kombëtar**. Për këtë arsye, çdo përpjekje për ta mësuar, shkruar dhe përhapur shqipen ishte njëkohësisht edhe një përpjekje për forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

Nga letra e vitit 1907 te komunikimi i sotëm

Sot jetojmë në një kohë kur një mesazh mund të udhëtojë nga një kontinent në tjetrin brenda pak sekondash. Telefoni, posta elektronike dhe rrjetet e komunikimit e kanë bërë pothuajse të menjëhershëm komunikimin njerëzor.

Por, pavarësisht ndryshimit të mjeteve, **thelbi i mesazhit të Petro Nini Luarasis mbetet aktual: të komunikosh në gjuhën tënde do të thotë të ruash një pjesë të identitetit tënd**.

Dorëshkrimi i tij i vitit 1907 na kujton se alfabetizimi dhe arsimi shqip nuk erdhën vetvetiu. Pas tyre qëndruan njerëz që punuan, sakrifkuan dhe u përballën me vështirësi të mëdha. Ata e kuptuan se një komb nuk mund të ndërtojë të ardhmen pa shkollën, pa librin dhe pa gjuhën e vet.

Pikërisht këtu qëndron edhe vlera e këtij dokumenti të vjetër. Ai nuk është vetëm një dëshmi bibliografike. Është **një dëshmi e një beteje kulturore dhe kombëtare**, në të cilën pena, abetarja, libri dhe shkolla ishin mjete të fuqishme të Rilindjes.

Trashëgimia që na flet edhe sot


Në faqet e historisë shqiptare, Petro Nini Luarasi mbetet i lidhur ngushtë me luftën për arsimin kombëtar dhe për përhapjen e gjuhës shqipe. Dorëshkrimi i vitit 1907 na jep mundësinë ta shohim këtë veprimtari edhe nga një këndvështrim tjetër: nga përpjekja për t'u mësuar shqiptarëve **artin e komunikimit të shkruar në gjuhën amtare**.

Një letër mund të dukej si një gjë e vogël. Por, në kushtet e asaj kohe, çdo faqe e shkruar shqip ishte një gur në themelin e kulturës kombëtare.

Prandaj, ky dorëshkrim duhet parë edhe si një mesazh për brezat e sotëm: **gjuha ruhet duke e përdorur, kultura ruhet duke e përcjellë dhe kujtesa kombëtare ruhet duke njohur njerëzit që punuan për të**.

Mbi një shekull më vonë, fjalët e Petro Nini Luarasis vazhdojnë të na kujtojnë fuqinë e komunikimit dhe të gjuhës. Nga një dorëshkrim i përgatitur në Amerikë në vitin 1907, vjen deri te ne zëri i një patrioti që besonte te shkolla, te libri dhe te fjala shqipe.

Sepse një letër nuk është vetëm një copë letër. Kur shkruhet në gjuhën e mëmës, ajo mund të bëhet edhe një copëz e historisë së një kombi.



15 GUSHT 1943 - KRIJOHET BRIGADA E PARË SULMUESE

Makrëzë, Vithkuq, lindja e një formacioni të ri të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

83 vjet më parë, më 15 gusht 1943, në fushën e Makrëzës, në Vithkuq të Korçës, u përrua Brigada e Parë Sulmuese e Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare, formacioni i parë i madh operativ i kësaj ushtrie. Krijimi i saj shënoi një moment të rëndësishëm në zhvillimin e organizimit ushtarak të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pasi nga çetat dhe batalionet partizane po kalohej drejt formacioneve më të mëdha, të afta për të vepruar në zona të ndryshme të vendit.

Krijimi i brigadave sulmuese ishte një nga detyrat e rëndësishme të përcaktuara pas krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së në Labinot, më 10 korrik 1943. Brigada nuk do të ishte më një formacion i kufizuar në një krahinë të caktuar, por një njësi operative që do të mund të lëvizte dhe të luftonte në hapësira të ndryshme të Shqipërisë. Pikërisht në këtë kuadër u mendua dhe u organizua Brigada e Parë Sulmuese.

556 luftëtarë nga krahina të ndryshme të Shqipërisë

Në fund të korrikut dhe në ditët e para të gushtit 1943, në Vithkuq filluan të grumbulloheshin luftëtarë të zgjedhur nga formacionet partizane ekzistuese. Ata vinin nga Korça, Elbasani, Berati, Vlo­ra, Gjirokastra, Tepelena, Dibra, Tirana, Shkodra e krahina të tjera.

Në momentin e krijimit, brigada kishte 556 luftëtarë, ndër të cilët edhe gra partizane. Ata u organizuan në katër batalione, ndërsa struktura e brigadës përfshinte edhe njësi të tjera mbështetëse të artilerisë dhe kundërtankut. Kjo përbërje e bëri Brigadën e Parë një formacion të ndryshëm nga çetat dhe batalionet e mëparshme, duke i dhënë asaj karakterin e një njësie të lëvizshme dhe operative.

Në krye të brigadës u caktua Mehmet Shehu, ndërsa komisar politik u caktua Tuk Jakova. Përzgjedhja e kuadrove dhe e luftëtarëve synonte krijimin e një force të disiplinuar, të aftë për të përballuar detyra luftarake në terrene dhe kushte të ndryshme.

Ceremonia e përrimit u zhvillua më 15 gusht 1943. Në fushën e Makrëzës ishin rreshtuar luftëtarët e brigadës, ndërsa në ceremoni morën pjesë drejtues të Partisë dhe të Shtabit të Përgjithshëm. Ceremonia u hap me Himnin e Flamurit. Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm, major Spiro Moisiu, përshëndeti efektivin dhe i dorëzoi brigadës flamurin luftarak.

Flamuri nuk ishte vetëm një simbol ceremonial. Ai përfaqësonte formimin e një strukture të re ushtarake, e cila do të vihej menjëherë në provën e luftimeve.

Nga Vithkuqi drejt fushave të betejës

Vetëm pak ditë pas përrimit, Brigada e Parë u përball me një nga provat e para luftarake. Më 17 gusht 1943, në kthesat e Barmashit të Kolonjës, ajo zhvilloi luftime kundër forcave gjermane. Kjo do të ishte pika e nisjes së një rruge të gjatë luftarake që do ta çonte brigadën në shumë prej zonave më të rëndësishme të Shqipërisë.

Gjatë muajve që pasuan, Brigada e Parë u përfshi në luftime në Jug dhe në Shqipërinë e Mesme, në Mallakastër, Kurvesh, Mesaplik, Dëshnicë, në zonën e Beratit, Elbasanit, Pogradecit e më tej. Operacioni i Dimrit 1943-1944 ishte një nga sprovat më të vështira. Brigada u detyrua të përballonte jo vetëm forcat kundërshtarë, por edhe dimrin, mungesën e ushqimeve, veshmbathjes dhe vështirësitë e terrenit.

Kjo periudhë do të kishte rëndësi të veçantë për fatin e brigadës. Mbijetesa dhe ruajtja e efektivit në kushtet e jashtëzakonshme të dimrit i mundësoi asaj të vazhdonte veprimtarinë luftarake dhe të merrte pjesë në operacionet e mëvonshme të vitit 1944.

“Antonio Gramshi” dhe zgjerimi i brigadës

Një zhvillim i veçantë në historinë e Brigadës së Parë ishte përfshirja në radhët e saj e ushtarëve italianë pas kapitullimit të Italisë fashiste, në shtator 1943.

Nga ushtarët italianë që nuk pranuan të vazhdonin luftën në krah të forcave gjermane u krijua batalioni “Antonio Gramshi”, i cili iu bashkua Brigadës së Parë. Burimet historike e vendosin formimin e këtij batalioni në vjeshtën e vitit 1943 dhe e lidhin atë me ushtarë të Divizionit “Firence”.


Kjo pjesëmarrje përbën një nga episodet më të veçanta të historisë së brigadës, pasi në radhët e saj luftuan së bashku shqiptarë dhe antifashistë italianë kundër pushtimit nazist.

Me zgjerimin e formacionit dhe krijimin e njërive të reja, efektiv i Brigadës së Parë u rrit ndjeshëm gjatë vitit 1944. Ajo u shndërrua në një forcë të madhe lëvizëse, e cila mund të angazhohej në operacione në distanca të largëta nga vendi ku ishte krijuar.

Një rrugë luftarake në të gjithë Shqipërinë

Në vitin 1944 Brigada e Parë ishte tashmë një nga formacionet më të rëndësishme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Ajo mori pjesë në luftime gjatë Operacionit të Qershorit dhe në veprimet e mëvonshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, duke kaluar në zona të ndryshme të vendit.

Një nga momentet më të rëndësishme të historisë së saj



ishte pjesëmarrja në luftën për çlirimin e Tiranës në nëntor 1944. Brigada ishte ndër formacionet që morën pjesë në betejat vendimtare për kryeqytetin, në ditët e fundit të luftës në Shqipëri.

Rruga e saj luftarake ishte e gjatë dhe e vështirë. Sipas burimeve të kohës dhe historikëve të brigadës, nga radhët e saj ranë qindra dëshmorë, ndërsa shumë të tjerë u plagosën gjatë luftimeve. Në kujtesën historike të brigadës përmenden mbi 370 të rënë. Midis tyre ishin edhe kuadro e komandantë të njërive të saj.

Në këtë listë përmenden emra të njohur të historisë së saj, si Gjok Doçi, Xheladin Beqiri, Fejzi Mecolli, Myslym Shyri, si dhe shumë luftëtarë të tjerë që ranë në betejat të ndryshme.

Brigada pati gjithashtu një numër të konsiderueshëm luftëtarësh që u nderuan pas luftës me titullin “Hero i Popullit”. Burime historike të botuara për brigadën përmendin 14 luftëtarë të saj të dekoruar me këtë titull.

Vlerësimi i Reginald Hibbert

Rëndësinë që mori Brigada e Parë gjatë luftës e ka vënë në dukje edhe oficeri britanik Reginald Hibbert, i cili shërbeu në misionin britanik në Shqipëri dhe më vonë botoi librin Fitorja e hidhur.

Në vlerësimin e tij për brigadën, Hibbert e përshkruan atë si një formacion elitë të forcave partizane, të kalitur nga vështirësitë e dimrit dhe nga luftimet, duke vënë në dukje disiplinën dhe aftësinë e saj për manovrim. Ai thekson gjithashtu se brigadat e tjera e shihnin atë si një model për t’u ndjekur. Ky vlerësim është cituar edhe në botime të mëvonshme ushtarako-historike shqiptare.

Në thelb, rëndësia e Brigadës së Parë nuk qëndron vetëm te numri i betejave në të cilat mori pjesë. Ajo ishte edhe një

provë për mënyrën se si Ushtria Nacionalçlirimtare po kalonte nga formacionet e vogla partizane drejt një organizimi më të madh, të aftë për të zhvilluar operacione të koordinuara në shkallë kombëtare.

Makrëza, një datë që mbeti në historinë ushtarake shqiptare

Më 15 gusht 1943, në fushën e Makrëzës së Vithkuqit, u hodh një nga themelet e organizimit të mëvonshëm të forcave të mëdha të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Brigada e Parë Sulmuese u krijua në një moment kur lufta në Shqipëri po hynte në një fazë të re dhe nevoja për formacione më të organizuara e më të lëvizshme po bëhej gjithnjë e më e madhe.

Ajo do të kalonte nga Vithkuqi në Barmash, nga betejat e Jugut në Shqipërinë e Mesme, nga vështirësitë e dimrit 1943-1944 te ofensivat e vitit 1944 dhe, në fund, te lufta për Tiranën. Përkrah emrit të brigadës mbetën emrat e qindra luftëtarëve që humbën jetën në fushën e betejës.

Për heroizmin e treguar gjatë veprimtarisë së saj luftarake, Brigada e Parë Sulmuese u dekorua me titullin e lartë “Hero i Popullit”.

Sot, 83 vjet pas asaj dite të gushtit 1943, përkujtimi i krijimit të Brigadës së Parë Sulmuese mbetet pjesë e historisë ushtarake të Shqipërisë dhe e kujtesës për brezat e luftëtarëve që morën pjesë në Luftën Antifashiste. Fusha e Makrëzës, ku u rreshtuan për herë të parë 556 luftëtarët e saj, mbetet simboli i një prej momenteve kur formacionet partizane shqiptare nisën të marrin përmasat e një ushtrie të organizuar.

15 gusht 1943 – 15 gusht 2026.

83 vjet nga krijimi i Brigadës së Parë Sulmuese të Ushtrisë Nacionalçlirimtare Shqiptare.

OKB paralajmëron: 2026, viti më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë

Një alarm global

Organizata e Kombeve të Bashkuara ka paralajmëruar se viti 2026 mund të hyjë në histori si viti më i nxehtë i regjistruar ndonjëherë. Ky paralajmërim nuk është thjesht një shifër statistikore, por një thirrje e fortë për veprim. Shkencëtarët e klimës e shohin këtë si një pikë kthese, ku kriza klimatike nuk është më paralajmërim, por realitet i prekshëm.

Një planet në ethe

Valët e të nxehtit kanë përfshirë kontinente të tëra. Evropa ka përjetuar temperatura mbi 45°C në Itali dhe Spanjë, duke thyer rekorde historike. Qytete si Madrid dhe Roma kanë raportuar ditë të gjata me nxehtësi të padurueshme, duke rrezikuar shëndetin e mijëra njerëzve. Azia është përballur me kushte ekstreme: Delhi dhe Pekini kanë kaluar javë të tëra me temperatura mbi 40°C, duke bërë që autoritetet të shpallin gjendje emergjente për shëndetin publik. Amerika ka parë uragane më të fuqishme se kurrë. Uragani “Lala” në Hawaii ka lënë mbi 100,000 persona pa energji elektrike, duke treguar se kriza klimatike nuk është vetëm nxehtësi, por edhe stuhi, përmbytje dhe fatkeqësi natyrore. Ky kombinim i nxehtësisë ekstreme dhe fenomeneve të dhunshme atmosferike po e bën jetën gjithnjë e më të pasigurt në shumë rajone të planetit.

Shkencëtarët alarmojnë

Ekspertët e klimës thonë se 2026 është një vit i veçantë për shkak të bashkëveprimit mes ngrohjes globale dhe fenomenit El Niño. El Niño ka sjellë rritje të temperaturave në Paqësor, duke ndikuar në klimën globale. Ngrohja e përgjithshme e planetit ka shtuar intensitetin e valëve të të nxehtit. Shkencëtarët paralajmërojnë se, nëse nuk merren masa drastike, vitet e ardhshme mund të sjellin kushte edhe më ekstreme. Disa rajone mund të bëhen të pabanueshme, ndërsa miliona njerëz do të detyrohen të migrojnë për shkak të klimës.

Pasojat ekonomike dhe sociale

Kriza klimatike nuk është vetëm një problem mjedisor – ajo po prek çdo aspekt të jetës.

Bujqësia: Thatësitrat e gjata po shkatërrojnë të korrat. Në Afrikë dhe Azi, miliona fermerë po përballen me humbje të mëdha, duke rrezikuar sigurinë ushqimore. Energjia: Rrjetet elektrike nuk përballojnë kërkesën e

lartë për ftohje. Në shumë vende, ndërprerjet e energjisë janë bërë të zakonshme gjatë verës.

Shëndeti publik: Rritja e temperaturave ka sjellë më shumë raste të goditjeve nga nxehtësia. Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëron për një rritje të sëmundjeve të lidhura me klimën, si dehidratimi, problemet kardiale dhe përhapja e sëmundjeve tropikale në zona të reja.

Pasojat sociale janë po aq të rënda: qytete të tëra po përballen me tensione për shkak të mungesës së ujit dhe energjisë, ndërsa migrimi klimatik po rritet ndjeshëm.

Thirrja e OKB-së



Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së ka bërë apel për masa urgjente:

- Reduktim drastik të emetimeve të karbonit, duke ulur varësinë nga karburantet fosile.
- Investime në energji të gjelbër, si dielli dhe era, për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme.
- Mbështetje për vendet më të prekura, që shpesh nuk kanë burime të mjaftueshme për t'u përballur me fatkeqësitë klimatike.

Ai ka theksuar se “koha për veprim nuk është nesër, por sot”. Nëse bota nuk arrin të ulë emetimet, pasojat do të jenë të pakthyeshme.

2026 po hyn në histori jo si një vit i zakonshëm, por si një alarm global. Ky vit mund të shënojë fillimin e një epoke ku kriza klimatike nuk është më paralajmërim, por realitet i prekshëm.

Nëse dekada më parë mbrojtja ajrore ishte e fokusuar tek raketat balistike dhe avionët, sot sfida kryesore është klima – një armik i padukshëm, por i pamëshirshëm. Lufta e së ardhmes nuk do të fitohet vetëm nga ata që kanë më shumë teknologji, por nga ata që kanë vendosmërinë për të mbrojtur planetin.





Beteja e padukshme: Si mbrohen ushtritë nga dronët

Deri tani kemi folur për dronët – për mënyrën se si ata kanë ndryshuar fushëbetejën moderne, duke u kthyer nga mjete të thjeshta zbulimi në armë strategjike me kosto të ulët. Por një aspekt që shpesh mbetet në hije është mbrojtja kundër dronëve. Nëse droni është “shigjeta” e luftës së sotme, atëherë sistemet kundër-dron janë “mburoja” e së ardhmes. Dhe kjo mburojë nuk është më thjesht një ide teorike, por një realitet që po testohet dhe zbatohet në shumë vende të botës.

Lazerët dhe mikrondat – energjia si armë

Një nga zhvillimet më të veçanta është përdorimi i sistemeve të energjisë së drejtuar. Këto sisteme nuk përdorin raketa apo municione tradicionale, por fuqi të pastër – rreze lazer ose valë mikrondash – për të neutralizuar dronët në ajër.

Në SHBA, programi HELIOS i Marinës ka instaluar lazerë në anije luftarake, të aftë të shkatërrojnë dronë të vegjël dhe raketa me një goditje të vetme. Ky është një hap i madh drejt një epoke ku energjia elektrike zëvendëson municionin klasik.

Izraeli ka prezantuar sistemin Iron Beam, një lazer që synon të plotësojë mbrojtjen e “Iron Dome”. Ky sistem është menduar për të neutralizuar dronët dhe raketat e vogla, duke ulur ndjeshëm koston e mbrojtjes.

Gjermania ka investuar në teknologji mikronde që prishin sistemet e navigimit të dronëve armikë, duke i bërë ata të humbasin orientimin dhe të bien.

Avantazhi i këtyre sistemeve është se mund të përdoren vazhdimisht pa shpenzime të mëdha për municion. Por sfida është e dukshme: kërkojnë energji të jashtëzakonshme dhe kushtet atmosferike mund të kufizojnë efektivitetin e tyre. Një lazer është më pak i fuqishëm në mjegull, shi apo pluhur, gjë që e bën të domosdoshme kombinimin me teknologji të tjera.

Kupola digjitale – mburoja elektronike

Një tjetër risi është mbrojtja elektronike, e njohur si “kupola digjitale”. Këto sisteme nuk e shkatërrojnë fizikisht dronin,

por e bëjnë të padobishëm duke ndërprerë komunikimin e tij.

Në Ukrainë, sistemet “jammer” kanë luajtur rol vendimtar, duke ndërprerë lidhjen mes operatorëve rusë dhe dronëve të tyre. Ky bllokim elektronik ka shpëtuar qindra trupa nga sulme të drejtpërdrejta.

Turqia ka zhvilluar sisteme që jo vetëm bllokojnë sinjalet, por edhe marrin kontrollin e dronit armik, duke e kthyer kundër operatorit. Ky është një hap përtej mbrojtjes – është një kundërsulm elektronik.

Britania ka testuar sistemin Drone Dome, që kombinon radarë, sensorë optikë dhe bllokim elektronik për të krijuar një mbrojtje të plotë kundër dronëve.

Kupolat digjitale janë efektive sepse nuk kanë nevojë të shkatërrojnë fizikisht dronin – mjafton ta bëjnë të padobishëm. Por dronët e rinj po zhvillohen me algoritme autonome, që mund të vazhdojnë misionin edhe pa komandë direkte. Kjo i detyron sistemet elektronike të evoluojnë vazhdimisht, duke u bërë gjithnjë e më komplekse.

Mbrojtja hibride – kombinimi i teknologjive

Ekspertët ndërkombëtarë po flasin për mbrojtjen hibride kundër dronëve.

Kupolat digjitale përdoren për të bllokuar shumicën e dronëve.

Lazerët dhe mikrondat aktivizohen për ata që arrijnë të depërtojnë.

Sistemet tradicionale kundërajrore mbeten si linja e fundit e mbrojtjes.

Ky kombinim krijon një arkitekturë të re mbrojtjeje ajrore, ku nuk mjafton vetëm raketa kundërajrore. Sot, mbrojtja është një rrjet i integruar elektronik, energjetik dhe fizik. Në një bazë ushtarake moderne, mund të shohësh radarë që zbulojnë dronët, kupola digjitale që i bllokojnë, dhe lazerë që i shkatërrojnë ata që arrijnë të kalojnë barrierat e para.

Shembuj ndërkombëtarë

SHBA: Programi HELIOS ka instaluar lazerë në anije luftarake për mbrojtje kundër dronëve dhe raketave.

Izraeli: Sistemi “Iron Beam” është testuar me sukses kundër dronëve të vegjël, duke u bërë një shtesë e domosdoshme për “Iron Dome”.

Britania: Projekti “Dragonfire” synon të mbrojë bazat ushtarake nga dronët dhe raketat e vogla me lazerë të avancuar.

Kina: Ka prezantuar sisteme mikronde që mund të shkatërrojnë grupe të tëra dronësh njëkohësisht, duke e parë këtë si një mënyrë për të balancuar fuqinë e kundërshtarëve.

Nëse dekada më parë mbrojtja ajrore ishte e fokusuar tek raketat balistike dhe avionët, sot sfida kryesore janë dronët – të vegjël, të lirë dhe të vështirë për t’u kapur. Lazerët, mikrondat dhe kupolat digjitale po krijojnë një ekosistem të ri mbrojtjeje, ku energjia dhe elektronika janë po aq të rëndësishme sa fuqia e zjarrit. Lufta e së ardhmes nuk do të fitohet vetëm nga ata që kanë më shumë dronë, por nga ata që kanë mbrojtjen më inteligjente kundër tyre.



BËHU OFICERI RI! FORCAVE TË ARMATOSURA!

Ke përfunduar studimet Bachelor dhe dëshiron të ndërtosh një karrierë në uniformë?

Ky është momenti yt!

Qendra e Personel Rekrutimit hap aplikimet për vitin akademik 2026–2027, për ndjekjen e Kursit të Përgatitjes së Oficerit në Akademinë e Forcave të Armatosura, duke ofruar 40 kuota studimi në profile të ndryshme profesionale.

Profilet e studimit:

3 KUOTA – Ndërlidhje (IT)
8 KUOTA – Logjistikë (Ekonomik, Financë, Menaxhim)
8 KUOTA – Inxhinieri (Gjeodezi, Mekanikë, Transport)
2 KUOTA – Xhenio/Infrastrukturë (Inxhinieri Ndërtimi)
2 KUOTA – Mjekësi e Përgjithshme
3 KUOTA – Navigim Detar
2 KUOTA – Kimi
2 KUOTA – Artileri Tokësore (Matematikë, Fizikë)
10 KUOTA – Këmbësori, Polici Ushtarake, Zbulim, Personel, Drejtësi dhe profile të tjera Bachelor

AFATI I APLIKIMIT: deri më 31 Gusht 2026

Bëhu pjesë e Forcave të Armatosura dhe kontribuo me profesionalizmin, dijen dhe përkushtimin tënd në shërbim të vendit.

Për më shumë informacion dhe kriteret e aplikimit klikoni këtu:

<https://www.mod.gov.al/.../stude.../7934-2026-08-04-09-33-03>